

SI TË PROJEKTOHET PËR NJË QYTET PA BARRIERA?

INSTRUKSIONE PËR HARTIMIN E NJË MANUALI
PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM PA BARRIERA

SI TË PROJEKTOHET PËR NJË QYTET PA BARRIERA?

INSTRUKSIONE PËR HARTIMIN E NJË MANUALI
PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM PA BARRIERA



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Ky produkt/hulumtim u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Përmbajtja është përgjegjësi e EC MaNdryshe dhe OPDMK dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Projekti “Prizreni, një qytet pa pengesa” zhvillohet në kuadër të Programit Angazhimi për Barazi, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe mbikëqyret nga ATRC dhe implementohet nga EC MaNdryshe dhe OPDMK.

Fotot sipas radhës 4, 11, 12, dhe 13 janë foto të autores.

Botues: EC MaNdryshe
Autor: Rozafa Basha

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren
Bulevardi Nënë Tereza,
H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

038-224-967
029-222-771

Përmbajtja

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE _____ 4

I. HYRJA _____ 6

II. PËRKUFIZIMET THEMELORE _____ 7

1. Aftësia e kufizuar _____ 7
2. Barrierat arkitektonike _____ 7
3. Përkufizimi i qasjes për Persona me aftësi të kufizuara _____ 8
4. Koncepti projektimi pa barriera _____ 9
5. Qasja për Persona me Aftësi të Kufizuara si e drejtë elementare njerëzore _____ 10

III. KUADRI LIGJOR VENDOR DHE I HUAJ _____ 11

1. Legjislacioni vendor _____ 11
2. Legjislacioni i huaj _____ 14
3. Praktikat e mira _____ 19

IV. PASQYRË E PROBLEMEVE THEMELORE NË MJEDISIN E NDËRTUAR NË PRIZREN _____ 26


1. Përmbledhje e problemeve nga fokus grupi me komunitetin e PAK _____ 29

V. UDHËZIME PËR APLIKIMIN E KONCEPTIT PA BARRIERA NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT DHE PROJEKTIMIT _____ 30

1. Elementet strategjike për një mjedis pa barriera _____ 30
2. Rekomandimi për hartimi i manualit për projektim pa barriera _____ 32
3. Organizimi i procesit planifikues _____ 33
4. Hapat e përgjithshëm për të siguruar një qytet pa barriera _____ 34

VI. KONKLUDIM _____ 35

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE



“Qytetet që vazhdojnë të kenë barriera të llojeve të ndryshme, janë qytete të “hendikepuara” dhe jashtëzakonisht jo ekonomike, përveç që janë qytete të diskutueshme nga aspekti social dhe human. Sociologët urbanë i kanë kushtuar një numër të madh të shkrimeve këtij argumenti delikat dhe në përgjithësi janë të pajtimit se moseliminimi i barrierave arkitektonike është një “punë e keqe” për gjithë kolektivin”¹

Ky dokument mëton ta udhëzojë komunën e Prizrenit se si ta hartojë një manual për projektim pa barriera, si dhe të propozojë procedurat e implementimit të kësaj rregulloreje në fazat e ndryshme të aktiviteteve ndërtimore në qytet. Dokumenti sugjeron përqafimin e konceptit të qytetit pa barriera qysh nga fazat e hartimit të programit të një ndërtese (pra përkufizimit të nevojave të komunitetit të PAK, si dhe të komuniteteve të tjera), e deri te fazat e dhënies së lejes ndërtimore, monitorimit të implementimit gjatë procesit

të ndërtimit, pranimi teknik, etj. Aspekt me rëndësi që propozohen në këtë drejtim është përfshirja në vendimmarrje rreth aktiviteteve ndërtimore në qytet (në infrastrukturë, në fondin banesor dhe në projektet kapitale) me pjesëmarrje të komunitetit.

Pjesa e parë e kësaj analize përfshin një përmbledhje të përkufizimeve themelore për aftësinë e kufizuar, barrierat që pengojnë lëvizjen e lirë, konceptet themelore të projektimit të barrierave si dhe rëndësinë e lëvizjes së lirë dhe të jetës së pavarur si e drejtë elementare qytetare e mbrojtur me konventa ndërkombëtare.

Po ashtu, në këtë dokument përmbledhet kuadri ligjor i Kosovës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ligji i ndërtimit, ligji i planifikimit hapësinor, udhëzuesit administrativ, etj.), si dhe praktikën e mira të trajtimit të këtyre çështjeve nga rregullore administrative dhe udhëzues për projektim pa barriera nga qyteti i Berlinit, udhëzuesit e ligjet italiane, të SHBA-ve dhe në aktet dhe ligjet e Bashkimit Evropian, duke mos i anashkaluar as sistemet e standardizimeve ndërkombëtare ISO dhe CENC.

¹ Parchi per tutti – fruibilità per un’utenza ampliata. Accessibilità e fruibilità delle strutture e dei servizi da parte di un’utenza ampliata alle persone con disabilità, agli anziani, ai bambini: Linee Guida per gli enti di gestione dei Parchi nazionali Italiani, ACLI, 2003

Duke qenë se qendra historike e Prizrenit është e mbrojtur me ligj, si dhe qyteti është një nga vendet me tërheqëse për turistë vendorë dhe ndërkombëtar, në kuadër të këtij dokumenti propozohet që si pjesë integrale të një manuali për projektim pa barriera, duhet të jenë edhe instruksionet për arritjen e qasshmërisë në ndërtesat e mbrojtura nga shteti, në mënyrë që të jenë të qasshme dhe të vizitueshme për të gjitha komunitetet. Intervënimet e tilla, kërkojnë kujdes dhe procedura të veçanta, dhe për këtë do të shohim praktikën nga shteti italian, duke u bazuar në udhëzuesin për qasje të personave me aftësi të kufizuara në trashëgiminë kulturore të hartuar nga Ministria e Kulturës dhe e Trashëgimisë Kulturore të Republikës italiane.

Në anën tjetër Prizreni brenda qytetit ka parqe por është i rrethuar me mjedis natyror të jashtëzakonshëm, i cili është destinacion i qytetarëve të Prizrenit por dhe i turistëve për rekreacion. Për këtë arsye në këtë manual propozohet një seksion i veçantë që këto parqe dhe mjedise natyrore (përfshirë këtu edhe parqet kombëtare) të bëhen të qasshme edhe për komunitetin PAK.

Më 20 maj 2016 në Prizren u mbajt një fokus grup me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim që nevojat dhe problemet me të cilat ky komunitet përballet për-

ditë të identifikohen dhe shqyrtohen në këtë dokument. Me këtë rast, të pranishëm ishin përfaqësues me aftësi të kufizuara motorike, shqisore dhe përfaqësues të organizatave që përfaqësojnë këtë komunitet. Gjatë diskutimit dolën në pah para së gjithash, vështirësitë e këtij komuniteti për jetë të pavarur në qytetin e Prizrenit, që mes tjerash ishte pasojë edhe e mundësive të kufizuara për të lëvizur në mënyrë të pavarur në qytet dhe për t'iu qasur vetë ndërtesave publike dhe shërbimeve të tjera në qytet. Janë të shumta barrierat me të cilat ky komunitet përballet përditë, dhe përpos atyre arkitektonike (fizike), ky komunitet përballet edhe me barrierat në komunikim, mendësinë kulturore dhe problemet shoqërore, si dhe barrierat e krijuara nga moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Gjatë diskutimit u propozuan të merren parasysh disa praktika të mira për të cilët pjesëmarrësit në diskutim ishin në njohuri tashmë, si dhe u theksua që kërkesa për rritje të qasjes në qytet për komunitetin PAK, ka të bëjë me kërkesën për trajtim jo më të veçantë, por të barabartë me të tjerët. Sepse, mjedisi i cili është më i qasshëm lejon gjithpërfshirje më të madhe dhe pjesëmarrje të qytetarëve në shoqëri. Mjedisi më i qasshëm mbështet jetën e pavarur dhe zgjedhjet autonome. Jo vetëm për komunitetin PAK, por për të gjithë.

I. HYRJA



“Komforti mjedisor – shumësia e tipareve që e bëjnë më të lehtë dhe më të sigurt për të gjithë shfrytëzimin e një vendi, hapësire a shërbimi” Fabrizio Vescovo, arkitekt

Ndryshimet shoqërore dhe demografike në nivel global në fund të shek. XX, dhe në fillim të shek. XXI, kanë bërë që çështja e ndërtimit pa barriera të jetë qendrore në kontekstin e planifikimit të qytetit dhe të projektimit të ndërtesave dhe hapësirave publike në veçanti. Në Kosovë kjo çështje ka filluar të aktualizohet në fillim të viteve 2000, nën presionin e OJQ-ve që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara. Prania e komunitetit ndërkombëtar, e në veçanti të atij nga Bashkimi Evropian, bëri që ky presion, të ketë impakt edhe në fushën e intervenimeve të para përmirësuese kryesisht në objekte publike. Duke qenë si problematikë e aktualizuar në këtë kontekst, në vitin 2007, si aneks i ligjit të ndërtimit nr. 2004/15, u hartua udhëzimi administrativ 33/2007 që përfshin Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për qasjen e personave me Aftësi të Kufizuara.

Përkundër këtyre përpjekjeve, situata reale është se udhëzuesi administrativ vazhdon të

mbetet në letër ndërsa komunat nuk i ndjekin si duhet procedurat për t'i implementuar këto kërkesa teknike në projektet arkitektonike dhe urbane. Dhe mbi të gjitha, planifikimi i intervenimeve ndërtuese dhe identifikimi i problemeve dhe nevojave nuk bëhet duke përfshirë komunitetin në këtë proces. Andaj mjedisi i ndërtuar vazhdon të jetë i paqasshëm, si dhe komunitetet e prekura nga këto aktivitete planifikuese dhe ndërtimore, në veçanti personat me aftësi të kufizuara, vazhdojnë të përballen me barriera në qytet. Ato pak përpjekje që bëhen për të lehtësuar qasjen, bëhen sa për sy e faqe, pa i marrë parasysh të gjitha rregullat që janë pjesë e udhëzuesit administrativ 33/2007 apo nevojat e komunitetit që do ta shfrytëzojë atë mjedis. Gjithandej në qytete mund të shihen intervenime gjysmake që kanë për qëllim përmbushjen sipërfaqësore të kriterit ligjor, por jo edhe zgjidhjen e problemeve reale. Inspektorët komunalë i kapërcejnë këto kritere gjatë vëzhgimit të implementimit të këtij udhëzimi administrativ. Kjo ndodh në të dy rastet, edhe kur kemi të bëjmë me punët përmirësuese dhe për punët e ndërtimeve të reja, të cilat normalisht do të duhej të ishin në pajtim të plotë me kriteret e këtij udhëzuesi administrativ.

Kjo është vetëm një paraqitje sipërfaqësore e një problemi të thellë dhe kompleks, si pasojë e të cilit, qasja dhe lëvizja e lirë dhe e pavarur në qytet mbetet problem kritik për komunitetet e personave me aftësi të kufizuara, por edhe popullsisë së moshuar si dhe të atyre që në një moment të caktuar të jetës kanë vështirësi të lëvizjes.

II. PËRKUFIZIMET THEMELORE



1. Aftësia e kufizuar

Deri vonë, modeli predominant sipas të cilit është përkufizuar aftësia e kufizuar është modeli mjekësor, i cili mëtonte që aftësinë e kufizuar ta shihte si tragjedi personale të individit. Ky model fokusohet në individin dhe në aftësinë e kufizuar specifike për te. Në vitet '70 të shekullit të kaluar, falë angazhimit të shumë aktivistëve të kësaj fushe, aftësia e kufizuar filloi të shikohej përmes modelit social, sipas të cilit aftësia e kufizuar është koncept i konstruktuar shoqëror i përkufizuar nga barrierat e përditshmërisë që shfaqen në jetë.

Sipas modelit social, kërkohet që shoqëria të përmirësojë jetën e njerëzve me aftësi të kufizuara, dhe me këtë lundin edhe kërkesat për eliminimin e barrierave dhe përmirësimin e qasjes në mjedisin e ndërtuar. Së voni, disa teoricienë të kësaj fushe po përpiqen të propozojnë një qasje të integruar, ku përvoja personale e aftësisë së kufizuar trajtohet bashkë me theksin politik të modelit social, përmes kampanjave, me anë të cilave kërkohet përmirësimi i përgjithshëm infrastrukturor dhe i shërbimeve.

Për të projektuar një mjedis i cili nuk ka barrierat për të gjithë individët, duhet njohur përvojën e aftësisë së kufizuar dhe të sëmundjeve si pjesë normale të jetës. Vetëm me një qasje të tillë të formësimit të një mjedisi, sigurohet lëvizje e lirë dhe jetë e pavarur dhe e dinjitetshme për personat me aftësi të kufizuar dhe komunitetet e tjera.

2. Barrierat arkitektonike

Cilado pengesë mund të përjetohet si barrierë për të arritur caqet tona. Ngado mund të hasim barrierat: barrierat në lëvizje, në hapësirë dhe kohë, në qasje, në komunikim, në perceptim dhe në shprehje. Barrierat mund të jenë edhe të padukshme. Muret, shkallët, pragjet dhe dyert janë barrierat që lehtë kuptohen dhe perceptohen, por ka edhe të tilla që nuk perceptohen lehtë. Barrierat që e kufizojnë spontanitetin, distanca që ndajnë njerëz, hapësira me zhurmë që pamundësojnë bisedën, etj.

Në përgjithësi barrierat në jetën e përditshme pengojnë apo kufizojnë rrjedhën e veprimeve, informatave dhe komunikimin. Disa

nga to përjashtojnë komunitete të caktuara, duke ua limituar mundësinë e një jete të lirë dhe të pavarur.

Koncepti i 'barrierës' duhet të kuptohet më gjerësisht. Disa ngjyra dhe disa shkronja mund të perceptohen më qartë se të tjerat; disa dysHEME mund të krijojnë fërkim më të mirë dhe kondita akustike më të mira që do ta lehtësonin orientimin.

Barrierat fizike e pengojnë lëvizjen e lirë dhe jetën e pavarur. Barrierat fizike në mjedisin e ndërtuar ndryshe i quajmë edhe barriera arkitektonike.



Sipas ligjit italian 13/892 me barriera arkitektonike nënkuptojmë:

- Pengesat fizike që pengojnë lëvizshmërinë e kujtdo, e në veçanti të atyre që për ndonjë arsye kanë aftësi motorike të reduktuar apo të penguar të përkohshme apo të përhershme.

- Pengesat që pengojnë apo ia kufizojnë secilit shfrytëzimin komod dhe të sigurt të pjesëve, mjeteve apo komponentëve,
- Mungesa e sinjaleve dhe qartësisë që mundësojnë orientim dhe njohje të vendeve dhe të burimeve të rrezeve për cilindo, e në veçanti për personat e verbër dhe shikim të dëmtuar, si dhe për të shurdhrit.

Krijimi i mjediseve aftësuese është cak i rëndësishëm etik i projektuesve arkitektonik dhe dizajnerëve urban. Evitimi i krijimit të barrierave të panevojshme që pengojnë dhe kufizojnë pavarësinë dhe pjesëmarrjen shoqërore është në të mirën e të gjithëve.

3. Përkufizimi i qasjes për Persona me aftësi të kufizuara

Qasja fizike krijon një kontribut vital në rritjen e pjesëmarrjes sociale të njerëzve me aftësi të kufizuara³

Me qasje (qasshmëri) nënkuptojmë karakteristikat cilësore që e lejojnë shfrytëzimin e plotë të mjedisit të ndërtuar si dhe të mjeteve; në kuptim të gjerë, ajo përfshin sigurinë dhe komforin⁴.

Ekzistojnë përkufizime të shumta për qasje për PAK. Sipas Handicap International⁵, mjedisi i qasshëm është ai që mundëson lëvizje të lirë dhe pa pengesa, pavarësisht moshës, gjinisë dhe aftësisë. Përkufizimin për qasjen mund ta ndajmë edhe në:

- Qasja në mjedis të ndërtuar – banim, ndërtesa publike dhe private, hapësirat publike, etj.
- “Qasja gjeografike”, secili njeri duhet të ketë të drejtë dhe mundësi që të përzgjedh mënyrat e transportit dhe të shko-

2 Legge 13/89, Disposizioni per favorire il superamento e l'eliminazione delle barriere architettoniche negli edifici privati (Dispozitat për favorizimin e kapërcimit dhe eliminimit të barrierave arkitektonike në ndërtesa private). <http://www.handylex.org/stato/d140689.shtml>

3 How to Design and Promote an environment accessible to all, Policy Paper, Handicap International, 2009

4 Vescovo, F., UNIVERSAL DESIGN, un nuovo modo di pensare il sistema ambientale per l'uomo, artikull i publikuar në revistën “Paesaggio Urbano”, n.1/2000

5 Po aty.

jnë nga një vend në tjetrin, sipas nevojave, aftësive dhe buxhetit

- Qasja në informata dhe komunikim (media të qasshme, informata të qasshme, mesazhe të qasshme).

Në kuptimin të gjerë termi i qasjes përfshin të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore dhe politike – “qasja sociale” (qasja në punësim, arsim, sport, kulturë, rekreim, etj.).

4. Koncepti projektimi pa barriera

Të projektosh për persona e jo për norma⁶

Sipas Parimeve të Dizajnit Universal të Ministrisë së Tokës në Japoni⁷, për ta ndërtuar një shoqëri në të cilën të gjithë do të mund të ushtrjnë individualitetin, shkathësitë si dhe të marrin pjesë në mënyrë të plotë në shoqëri, është e rëndësishme që të përvehtësohen perspektivat e “drejtësisë”, pra e mosdiskriminimit të shfrytëzuesve, “lirisë së zgjedhjes – fleksibilitetit”, i cili lejon fleksibilitet në përmbushjen e nevojave të shfrytëzuesit, “pjesëmarrje” që inkurajon planifikim me pjesëmarrjen e shfrytëzuesve duke u bazuar në konceptin e dizajnit universal – “projektimit të objekteve që janë lehtësisht të përdorshme gjithkund dhe prej gjithkujt”⁸.

Qasja pa barriera është koncept që shpeshherë të tjerët e ndërlidhin vetëm me komunitetin e personave me aftësi të kufizuar – si dhe lëvizshmërisë së kufizuar në veçanti.⁹ Por, nga një mjedis pa barriera përfitues janë të gjithë njerëzit. Andaj, dizajni universal është dizajni i produkteve dhe mjediseve që të jenë të shfrytëzueshme nga të gjithë, në

masë sa më të madhe, pa nevojë adaptimi apo projektimi të specializuar.¹⁰

“Dizajni për të gjithë”¹¹, që përdoret më shumë në Evropë, thotë: dizajn për diversitet njerëzor, gjithëpërfshirje sociale dhe barazi. Sipas këtij koncepti, intervenimi në mjedis, produkte dhe shërbime që kanë për qëllim që të gjithë, përfshirë gjeneratat e ardhme, pa marrë parasysh moshën, gjininë, aftësinë apo prejardhjen kulturore do të kenë të drejtë të marrin pjesë në ndërtimin e shoqërisë sonë, me mundësi të barabarta duke marrë pjesë në aktivitete shoqërore, kulturore, rekreuese dhe argëtuese, duke pasur mundësi t’i qasen, shfrytëzojnë dhe kuptojnë të gjitha pjesët e mjedisit në mënyrë sa më të pavarur.

Në Britaninë e madhe përdoret më shumë termi “Dizajni gjithëpërfshirës”¹², i cili përkufizohet si vijon: Dizajni i produkteve dhe shërbimeve kryesore, i cili është i qasshëm dhe i përdorshëm nga sa më shumë njerëz që është e mundshme... pa nevojë të adaptimit special apo dizajnit të specializuar.

Sipas përkufizimeve të Universal Design: Creating Inclusive Environments¹³, dizajni universal e bën jetën më të lehtë dhe më të shëndetshme. Ky dizajn përfshin përmirësimin e vazhdueshëm duke u bazuar në burimet që janë në dispozicion, drejt cakut të fundit, që është gjithpërfshirja. Dizajni universal duhet të njohë kontekstin në të cilin dizajni do të bëhet, më parë sesa të imponojë një rregull standarde në secilën situatë. Në fund ky koncept propozon që gjithpërfshirja

6 Mezzalana, Fabrizio, arkitekt specialist i projektimit për të gjithë, pjesë e ligjëratës së mbajtur në kuadër të Seminarit në Peccioli, nëntor 2012, me temë “La normativa italiana in tema di progettazione accessibile”, <http://www.informareunh.it/wp-content/uploads/gMezzalana.pdf>

7 General Principles of Universal Design, Ministry of Land, Japan, 2005

8 Termi Dizajni Universal (Universal Design), së pari u përdor nga Roland Mace nga North Caroline State University në vitet ’70 të shekullit të kaluar.

9 General Principles of Universal Design, Ministry of Land, Japan, 2005

10 Mace, R., Center for Universal Design, North Carolina State University, 1997, https://www.ncsu.edu/ncsu/design/cud/about_ud/udprinciples.txt

11 Design for all, është filozofi projektimi, e cila si term përdoret më shumë në Evropë, p.sh. Berlin – Design for all, manuali për dizajnimin e ndërtesave publike dhe hapësirave publike të qytetit të Berlinit, etj.

12 Inclusive Design përkufizimi sipas The British Standards Institute (2005), <http://www.bsigroup.com/en-GB/about-bis/media-centre/press-releases/2005/2/New-British-Standard-addresses-the-need-for-inclusive-design/>

13 Steinfeld, E., Maisei, J., Universal Design – Designing Inclusive Environments, pp. 29-30, Wiley, 2012

duhet të adresojë gjithë diversitetin e popullatës dhe nuk fokusohet vetëm në dizajnin e mjedisit, por koncepti është njësoj i aplikueshëm edhe në botën virtuale të informatës dhe në ofrimin e shërbimeve.

5. Qasja për Persona me Aftësi të Kufizuara si e drejtë elementare njerëzore

Përbrenda Strategjisë Evropiane për Aftësinë Kufizuar 2010 – 2020, një nga përkushtimet kyçe është “Sigurimi i qasjes në mallra, shërbime dhe mjete asistive për njerëz me aftësi të kufizuara” dhe ky përkushtim shihet si parakusht për pjesëmarrjen në shoqëri dhe ekonomi.¹⁴

Në kornizën udhëzuese për arritjen e mundësive të barabarta dhe të gjithëpërfshirjes së sociale për të gjithë personat në unionin evropian (2004), thuhet që me qëllim të fuqizimit të njerëzve në shoqëri, institucionet e BE-së janë të obliguar që të garantojnë largimin e barrierave fizike që i pengojnë njerëzit të marrin pjesë, si dhe të vendosin respektin, dinjitetin, autonominë dhe pavarësinë për të gjithë.¹⁵

Programi i UN Habitatit përkufizon qytetin gjithëpërfshirës si qytet që promovon zhvillimin dhe rritjen në bazë të barazisë dhe drejtësisë (UN Habitat 2013). Barazia dhe drejtësia janë parimet bazë me të cilat qyteti prodhohet si dhe duhet të jetë i qasshëm për të gjithë dhe i menaxhuar përmes proceseve demokratike. Proceset demokratike dhe gjithëpërfshirëse promovojnë përmirësim në mjedisin fizik, zhvillimin shoqëror në qytet.¹⁶

Dokumenti themelor që rregullon të drejtat

e PAK është Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, e cila u hartua në vitin 2008 dhe hyri në fuqi në vitin 2010. Në preambulën e saj theksohet parimi “të gjitha të drejtat njerëzore janë universale, të pandashme, të ndërrarura dhe të ndërlidhura” (nga deklarata e Vjenës). Aty po ashtu theksohet se është e rëndësishme qasja në mjedisin fizik, shoqëror, ekonomik dhe kulturor, arsim, shëndetësi, informatë dhe komunikim, për t’i mundësuar PAK që t’i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë fundamentale.

Qëllimi i kësaj deklarate është i përvijuar në nenin 1, sipas të cilit konventa promovon, mbron, dhe siguron që PAK të gëzojnë në mënyrë të plotë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe promovon respektin për dinjitetin e tyre. Kjo konventë në nene të caktuara mbulon fusha të ndryshme, bazuar në konventat e tjera të KB. E veçanta e kësaj konvente janë e drejta për qasje, sipas së cilës të gjitha shtetet nënshkruese duhet të ndërmarrin masa për të siguruar qasjen e PAK në baza të njëjta me të tjerët, në mjedisin fizik, në transport, përfshirë këtu informatën dhe teknologjinë dhe sistemet komunikuese, si dhe në objekte të tjera dhe shërbime që janë të hapura apo që ofrohen për publik, si në mjediset urbane ashtu edhe në ato rurale. Me anë të këtyre masave kërkohet eliminimi i barrierave në mes të tjerash në:

- Ndërtesa, rrugë, transport, objekte dhe mjedise të jashtme dhe të brendshme, përfshirë këtu shkollat, banimin, objektet shëndetësore dhe vendet e punës;
- Informatat, komunikimet dhe shërbimet tjera, përfshirë këtu shërbimet elektronike dhe ato të emergjencës.

Në këtë nen kërkohet që shtetet të hartojnë, dekretojnë dhe monitorojnë zbatimin e standardeve minimale dhe udhëzuesit për qasje në objekte dhe shërbime që janë të hapura apo të ofruara për publik, duke siguruar që edhe entitetet private që kanë shërbime për

14 European Disability Strategy 2010 – 2020, A Renewed Commitment to a Barrier Free Europe, European Commission, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0636:FIN:en:PDF>

15 Basha, R., Disability and Public Space: Case Studies of Prishtina and Prizren, International Journal of Contemporary Architecture “The New Arch” Vol. 2, No. 3, (2015), pp. 54–66

16 Po aty

publik t'i aplikojnë të njëjtat.

Neni 19 thekson të drejtën e jetës së pavarur të PAK si dhe përfshirjen në komunitet. Ndërsa neni 29 thekson të drejtën e pjesëmarrjes në jetë politike si dhe në jetë publike në bazë të barabarta me të tjerët. Neni 30 thekson të drejtën e pjesëmarrjes në jetë kulturore, rekreim dhe sport.

III. KUADRI LIGJOR VENDOR DHE I HUAJ

1. Legjislacioni vendor¹⁷

Qeveria e Republikës së Kosovës është e angazhuar dhe e përkushtuar në hartimin dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme ligjore, politikave, programeve të qëndrueshme dhe mekanizmave institucionalë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal të qeverisjes.

Legjislacionin për Personat me Aftësi të Kufizuar është i ndarë në tri fusha si vijon:

1. Ligjet specifike të dedikuara për PAK;
2. Ligjet, të cilët përmbajnë dispozita që i përkasin PAK;
3. Udhëzime administrative dhe rregulloret për PAK;

Ligjet më të rëndësishme të dedikuara në mënyrë specifike për PAK janë:

- Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar, Nr. 2003/23
- Ligji për Përkrahjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, Nr. 03/L-022
- Ligji për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar, Nr. 03/L-019 - Ligji për Personat e Verbër Nr.04/L-092

Ligjet që përmbajnë provizione relevante lidhur me PAK janë:

- Ligji për Shëndetësi Nr. 04/L-125 - Ligji i Punës, Nr. 03/L-212
- Ligji mbi Ndërtimin, Nr. 2004/15
- Ligji Kundër Diskriminimit, Nr. 2004/3
- Ligji për Skemën e Asistencës Sociale,

¹⁷ https://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:f4M1x-B0IxNUJ:https://zgm.rks-gov.net/Portals/0/Docs/New%2520folder/strategjia_nacionale_finale_per_shtyp_3_gjuhet_bardh_e_zi_88013.pdf+&cd=1&hl=en&ct=clnk&client=firefox-b

Nr. 2003/15

- Ligji mbi Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032
- Ligji për Sportin Nr. 04/L-075

Janë edhe tri akte legjislativ të rëndësishme për PAK:

- Rregullorja Nr. 2000/66 mbi Beneficionet e Invalidëve të Luftës të Kosovës dhe për më të Afërmit e Tyre që Kanë Vdekur si Pasojë e Konfliktit të Armatosur në Kosovë;
- Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasje të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 33/2007
- Udhëzimi Administrativ për Procedurat e Aplikimit për Njohjen e të Drejtave për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 03/2010

1.1. Objektivat strategjike

Strategjia Nacionale për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (2013-2023)¹⁸, që do t'i paracaktojë politikat, veprimet dhe strategjitë sektoriale të të gjitha institucioneve dhe vetë shoqërisë për një dekadë, është e strukturuar në pesë (5) fusha si në vijim: Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Punësim, Arsimi, Mbrotjtje Ligjore, Qasja (informimi, komunikimi, pjesëmarrja) Statistikat.

Objektivat strategjike do të detajohen dhe specifikohen edhe me veprime konkrete, synime, tregues të matshëm, specifik, të arritshëm, real, institucione përgjegjëse për zbatimin e secilit aktivitet, afate kohore dhe linja buxhetore në kuadër të planeve të veprimit. Objektiva strategjike janë si vijon:

1. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuar Objektiva Strategjike
2. Sistem funksional dhe i mirëfilltë për

mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar Objektiva Strategjike

3. Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara Objektiva Strategjike
4. Qasje e barabartë në mbrojtje ligjore si dhe ofrimi i shërbimeve në nivelin lokal për përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar Objektiva Strategjike
5. Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe në krijimin apo vendosjen e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuar.

1.2. Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasje të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 33/2007

Ky udhëzim është aneks i ligjit të ndërtimit dhe mëton të sigurojë qasjen e papenguar, lëvizjen, qëndrimin dhe punën e PAK, si dhe modernizimin e qasjes në objektet ndërtimore publike për destinim pune, banesore-afariste, banesore, si dhe kushtet e përshatshmërisë së thjeshtë tek objektet banesore -afariste.

Ky udhëzim përkufizon termat themelore që i përkasin aftësisë së kufizuar dhe ndërtesat publike që obligohen ta zbatojnë këtë udhëzim, si objektet publike dhe administrative dhe ato të banimit dhe banimoro-afariste. Për ndërtesa publike dhe administrative, ky udhëzues liston objektet që merren me veprimtari tregtare, hotelierike, bankat, postat, objektet të vetëqeverisjes lokale, objektet të qeverisjes shtetërore, administrata, gjykatat, ndërtesat e shëndetësisë dhe të rehabilitimit, ndërtesat që dedikohen për arsim, ndërtesat e kulturës, sportit, rekreimit, ndërtimet e dedikuara transportit, ndërtimet e dedikuara për argëtim, ndërtimet fetare, ndërtesat për bujtjen e dënim, sipërfaqet dhe hapësirat publike, etj.

¹⁸ https://zqm.rks-gov.net/Portals/0/Docs/New%20folder/strategjia_nacionale_finale_per_shtyp_3_gjuhet_bardh_e_zi_88013.pdf

Udhëzimi lejon përjashtimin, pra heqjen dorë nga aplikimi i elementeve qasëse tek objektet e trashëgimisë kulturore, nëse intervenimi për të përmirësuar qasjen vlerësohet se i cenon vlerat e monumentit (neni 52), me kusht që merret pëlqimi i MMPH-së për këtë përjashtim. Sipas këtij udhëzimi, këtij vendimi duhet t'i bashkëngjitet mendimi i një organi kompetent për vlerat e objektit të trashëgimisë.

Këtij përjashtimi i nënshtrohen edhe pjesët e vendbanimit dhe objekteve ndërtimore për të cilat është përcaktuar mbrojtja në harmoni me rregulloret e veçanta nga lëmi i mbrojtjes së natyrës. Në këto raste qasja realizohet përmes elementeve të përkohshme qasëse montuese-demontuese.

Ky udhëzim jep dimensionet themelore të elementeve qasëse në nivele të ndryshme, të elementeve qasëse për jetë të pavarur (p.sh. hapësira hyrëse, komunikimi, WC, kuzhina, dhoma, klasa, hapësira e punës, banesa, kafenetë dhe restorantet, gardërobat, hyrja në ujë në pishinë, vendet në tribuna, telefonat, bankomat, instalimet elektrike, sportel, plani për orientim të lëvizjes në ndërtesa dhe të ngjashme, etj.). Po ashtu, në këtë udhëzim përfshihen edhe elementet e qasjes në komunikacion publik (vend-ndalja dhe peroni, parkingu, sipërfaqet publike për këmbësorë, semafori, vendkalimi i këmbësorëve, etj.). Të gjitha këto janë të ilustruara me skica të dimensionuara, për t'ua bërë më të qarta arkitektëve dhe inxhinierëve për zbatim në projektet e tyre.

Në fund të këtij udhëzimi jepet përmbajtja e domosdoshme e projektit arkitektonik të ndërtimit dhe të rindërtimit të objekteve arkitektonike dhe infrastrukture, duke i përfshirë të gjitha fazat projektuese.

Ky udhëzim administrativ i përmbledh pothuajse të gjitha problemet themelore të qasjes. Mirëpo, mungon një elaborim më i thellë i problemit të qasjes në hapësira publike,

shfrytëzimi i tyre dhe dizajni i mobiliarit urban për PAK, lojërat për fëmijë me aftësi të kufizuar, qasja edhe shfrytëzimi i hapësirave të gjelbra. Po ashtu, qasja për PAK në ndërtesa që bëjnë pjesë në fondin e trashëgimisë kulturore duhet të elaborohet më shumë, meqë sot ekzistojnë praktika në Evropë, por edhe mundësi teknologjike që e mundësojnë këtë. Mosinsistimi në rritjen e qasjes për PAK në këto ndërtesa dhe tërësi, mund të përjashtojë një komunitet të madh të banorëve të qytetit por edhe turistëve që të gëzojnë të drejtat për të vizituar dhe shijuar këto ndërtesa dhe mjedise. Siç u tha më lart, sot ekzistojnë zgjidhje inovative për mundësimin e qasjes me elemente që nuk cenojnë vlerat e objektit dhe që janë intervenime reversibile, ose përmes teknologjisë informative dhe të komunikimit, mundësohet qasja virtuale në to.



Foto: Muzeu etnografik i qasshëm, Lubjanë, Slloveni. www.dostopnost.eu

2. Legjislacioni i huaj

2.1. ADA – American Disability Act (Ligji amerikan mbi aftësinë e kufizuar)¹⁹

Ligji i Amerikan për Aftësinë e kufizuar, në fakt është ligj i punës, përditësimi i fundit i të cilit është bërë në vitin 1990. Ky ligj ndalon diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar dhe i obligon punëdhënësit që të ofrojnë akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, përfshirë këtu edhe kërkesat për qasje fizike në ndërtesat publike. Me këtë ligj përfaqësohen një numër shumë i madh i aftësive të kufizuara (gjendje shëndetësore fizike dhe mentale). Ligji është i ndarë në disa tituj. Në titullin e parë ndalohet diskriminimi në punësim i personit të kualifikuar me aftësi të kufizuar. Në titullin e dytë rregullohen entitetet publike, përfshirë transportin publik. Në këtë seksion ndalohet diskriminimi nga entitetet publike në nivel komunal, të qytetit, shtetit, etj. Në këtë seksion po ashtu rregullohet qasja në transport publik (qasja për karroca, etj.)

Në titullin e tretë, mes tjerësh përfshihet edhe qasja fizike në të gjitha ndërtesat dhe shërbimet (banim kolektiv, individual, ndërtesa të sportit, rekreacionit, arsimit, terminalët, lokalet, dyqanet, etj. Një nga definicionet e diskriminimit në këtë seksion është edhe moslargimi i barrierave nga ndërtesat ekzistuese. Disa përmbajtje dhe tipologji të ndërtesave mund të mos pajtohen me këtë titull (klubet private dhe ndërtesat e disa komuniteteve religjioze). Ndërsa ndërtesat e trashëgimisë, janë të obliguara që të jenë në pajtueshmëri me këtë titull, për aq sa intervenimet përmirësuese për qasjen e PAK nuk e dëmtojnë vlerën historike të ndërtesës dhe lokacionit²⁰.

2.2. European Accessibility Act (Ligji Evropian mbi qasjen fizike)

Ky ligj ka për qëllim që ta përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm të produkteve dhe shërbimeve të qasshme, duke i larguar barrierat të krijuara nga ligjet divergjente. Me këtë mëtohet që të lehtësohet veprimtaria e kompanive dhe do të bëjë që komuniteti i PAK dhe i pleqëve në BE të përfitojnë.²¹

Një numër i standardeve të qasjes janë në proces të zhvillimit në nivel evropian pas kërkesës për standardizim që Komisioni Evropian i ka drejtuar Organizatës Evropiane për Standardizim (ESO) për bashkërendim të zhvillimit të vullnetshëm të standardeve Evropiane me zhvillimet më të reja globale. Këto kërkesa kanë të bëjnë me specifikuat me Teknologjinë Informativë dhe Komunikuese, me mjedisin e ndërtuar, si dhe me integrimin e qasjes sipas qasjes “design for all” në standardizimin evropian.²²

Në vitin 2012, Komisioni Evropian angazhoi ANED²³ për të përpiluar raportet për qasje për të gjitha vendet anëtare dhe atyre që ishin candidate për të qenë anëtare të BE-së. Ky raport përmbledhë politikat aktuale dhe situatën e përgjithshme ligjore në këto vende, dhe është i një rëndësie të madhe, meqë është dokumenti bazë për t'i ndërtuar instrumentet evropiane dhe për të ndërmarrë masa për përmirësimin e qasjes në mallra, shërbime dhe mjedis të ndërtuar në përgjithësi. Sipas këtij raporti dëshmohet se masat kombëtare të shteteve të ndryshme në BE variojnë dukshëm në llojin e obligimeve dhe në nivelin e detajeve.

21 <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1202>

22 Proposal for a Directive of the European Parliament and of the Council on the approximation of the laws, regulations and administrative provisions of the member states as regards the accessibility requirements for products and services, European Commission, 2015

23 ANED – Academic Network of Experts of Disability është krijuar nga Komisioni Evropian në vitin 2007, si organ që do të mbështes hartimin e politikave në fushën e aftësisë së kufizuar.

19 <https://www.ada.gov/pubs/adastatute08.htm#12101>

20 https://en.wikipedia.org/wiki/Americans_with_Disabilities_Act_of_1990

Sipas këtij raporti kërkesat për qasje përvijohen në tri nivele:

1. Obligimi i përgjithshëm për qasje, sipas të cilit ligji, apo kodi i përgjithshëm, specifikon se të gjitha produktet dhe shërbimet duhet të jenë të qasshme për PAK (mirëpo, ky nivel nuk specifikon mënyrën se si kjo mund të arrihet);
2. Kërkesat specifike për qasje: ku ligji apo rregullorja jep kriteret specifike se si produkti a shërbimi mund të bëhet më i qasshëm (por, jo doemos i specifikon standardet teknike;
3. Specifikimet e detajuara teknike – kur ligji dhe kodi i jep rregullat e detajuara për dizajnimin e produktit dhe shërbimit (por këto rregulla mund të jenë të obligueshme apo vullnetare).

Ky raport është mjaft i gjerë, mirëpo këtu do të prezantojmë vetëm rezultatet e anketës që ndërlidhen me mjedisin e ndërtuar. Në të gjitha shtetet e EU-së ekzistojnë obligime gjenerale për t'i bërë ndërtesat publike të qasshme, me kërkesa specifike që ndërlidhen me tipologji të caktuara (p.sh. Shkollat) që shtrihen edhe tek ndërtesat private, përpos atyre publike. Dhe këto janë të bazuara në ligjet nacionale jo diskriminuese. Ligji i BE-së këtë çështje e prek tërthorazi, në ligjin për Shëndetësi dhe Siguri në të cilën shtrohen masa të veçata për punëtorë me aftësi të kufizuara.

Sipas ligjit të BE-së për prokurim, autoritetet dhe entitetet kontraktuale lejohen që të implementojnë masa të ndryshme për të promovuar mundësi të barabarta kur përzgjedhin fituesin e tenderit. Ata ftohen që t'i shënojnë kërkesat për qasjen e PAK në specifikimet teknike në tenderët publikë. Përpos mjedisit të ndërtuar kjo përfshin edhe mallrat dhe shërbimet.²⁴

Sa iu përket objekteve publike, sipas këtij raporti, të gjitha shtetet e anketuara (28 sosh), përpos Hungarisë, kishin kërkesa

specifike kombëtare për qasje në objekte të qeverisë. E njëjta vlen edhe për objektete arsimore (publike dhe private), shëndetësi (spitalet dhe shtëpitë e shëndetit), objektet publike dhe private të rekreimit dhe sportit. Një pasqyrë e ngjashme është pak a shumë edhe në rastin e hoteleve, dyqaneve, bareve, bujtinave, bankave, etj.

Sa iu përket vendeve të punës dhe banimit (banimit shumëbanesorë dhe privat), pasqyra është më ndryshe. Ka shtete që këto tipologji sa i përket qasjes fizike nuk mbulojnë specifikisht në kuadrin ligjor (Shembull Austria, Slovakia, Sllovenia dhe Hungaria). Sa i përket qasjes në hapësira publike, situata shfaqet përsëri sikurse te qasja në objekte publike. Është një numër mjaft i madh i shteteve që raportojnë kërkesa specifike për mobiliarin urban. Në fund të kësaj pjese do të shtoja edhe të dhënat e hulumtimit në lidhje me transportin, në veçanti me autobusët, ku obligimi i përgjithshëm për autobusë të qasshëm për PAK është në 71.4% nga 28 shtete, ndërsa kërkesat specifike për qasje për PAK në autobusë, janë 55,6% të shteteve të anketuara. Një pasqyrë e detajuar nga ky raport për disa shtete evropiane dhe të rajonit është e prezantuar në pikën 2.5. të këtij dokumenti.

2.3. Standardet e qasjes sipas ESO (European Standardization Organization)²⁵

Janë tri organizata evropiane të standardizimit, CEN, CENELEC dhe ETSI, të cilat njihen si organizata kompetente në fushën e standardizimeve teknike. Korniza ligjore e BE-së (1025/2012), e cila rregullon fushën e standardizimeve teknike është miratuar nga Parlamenti Evropian dhe këshilli i BE-së. Këto tri organizata evropiane bashkëpunojnë në çështjet e politikave dhe teknike të inter-

²⁴ http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-15-6148_en.htm

²⁵ Sektori CEN_CENELEC në Organizata Evropiane e standardeve përmban standardet e qasjes dhe atë në sektorin e prokurimit publik për kontrata ndërtimore, standarde të qasjes në sektorë të tjerë, koncepti Design for all, etj.

esit të përbashkët. Si organi më i lartë i politikbërjes në fushën e standardizimit evropian, këto organizata marrin parasysh zhvillimet politike dhe ekonomike të cilat mund të ndikojnë në përpilimin e standardeve.

Një nga sektorët e rëndësishëm të kësaj organizate është ai i Qasjes, i cili i mbulon disa fusha. Si sektorë më të rëndësishëm që ndërlidhen me mjedisin e ndërtuar dhe shërbimet, janë si vijon:

- Prokurimi publik – në vitin 2011, Komisioni Evropian e adoptoi propozimin për reformimin dhe modernizimin e prokurimit, në mënyrë që të sigurojë një qasshmëri më të madhe të produkteve, shërbimeve dhe të mjedisit të ndërtuar. Direktiva e transformuar e prokurimit publik, e cila ka inkuadruar termin e qasshmërisë, përfshin dy fusha, prokurimin për teknologji informative/komputerike (M/376)²⁶ dhe prokurimin për mjedis të ndërtuar (M/430)²⁷.
- Design for all (Dizajni për të gjithë) – është sektor i CEN –CENELEC që merret me qasja Dizajni për të gjithë të inkuadrohet në të gjitha standardet për produkte dhe shërbime, në mënyrë që ato të jenë të qasshme për të gjithë. Në zhvillim e sipër janë disa nga produktet nga komitetet e punës, mes tjerash edhe një standard evropian EN²⁸ që do t'i propozohen ESO-s dhe Komisionit Evropian për aprovim, dhe i cili standard do të adresojë dizajnin, zhvillimin, procesin e prodhimit të mallrave dhe shërbimet si procese prioritare, në të cilat do të merren në konsideratë aspektet e qasjes për PAK dhe e personave të moshuar, si

dhe mënyrat se si të zbatohen parimet e Dizajnit për të gjithë.

2.4. ISO standardet për mjedis pa barriera

ISO 29 ka një portfolio të gjerë standardesh mbi qasjen, ku përfshihen mjedisi i ndërtuar, teknologjia informative dhe komunikimi, produktet specifike që ndërlidhen me mjetet asistive që ndihmojnë mobilitetin, sigurinë dhe cilësinë e jetës.

Mes një numri të madh të standardeve ISO për këtë fushë, vlen të përmenden dy standarde:

- ISO/IEC Guide 71:2001³⁰, që përmban udhëzuesin për zhvilluesit e standardeve për t'i adresuar nevojat e të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara
- ISO 21542:2011³¹, Ndërtimi – qasja dhe shfrytëzimi i mjedisit të ndërtuar, i cili i specifikon kërkesat dhe rekomandimet për shumë elemente të konstruksionit, komponenteve, instalimeve që e përbëjnë mjedisin e ndërtuar. Këto ndërlidhen me qasjen në ndërtesa, komunikimin e brendshëm, hyrjen në ndërtesë por edhe evakuimin në rast të emergjencave. Si dhe merret me menaxhimin e qasjes në ndërtesa

2.5. Legjislacioni në vendet e BE-së dhe atyre kandidate të BE-së³²

Gjermania

Në Gjermani e drejta për barazi dhe për mosdiskriminim mbrohet në nenet e Kushtetutës

26 <http://www.cencenelec.eu/standards/Sectors/Accessibility/PublicProcurement/Pages/M376.aspx>

27 <http://www.cencenelec.eu/standards/Sectors/Accessibility/PublicProcurement/Pages/M420.aspx>

28 EN janë dokumente që ratifikohen nga një nga tri organizatat evropiane të standardizimit (ESO-të), CEN, CENELEC ose ETSI. Një EN (standard evropian) "mbart në vete obligimin për t'u implementuar në nivel kombëtar dhe i jepet status i standardit kombëtar(...)". Një EN automatikisht bëhet një standard kombëtar në secilin nga 33 shtetet anëtare të CEN-CENELEC.

29 ISO (Organizata ndërkombëtare e standardizimit) është organizatë e pavarur dhe jo qeveritare, që merret me zhvillimin vullnetar të standardeve ndërkombëtare në shumë fusha të veprimtarisë.

30 http://www.iso.org/iso/catalogue_detail?csnumber=33987

31 http://www.iso.org/iso/catalogue_detail?csnumber=50498

32 Sipas Raportit të ANED mbi qasjen në të gjitha vendet anëtare dhe atyre që ishin kandidate për të qenë anëtare të BE-së.

Priestly, M., National accessibility requirements and standards for products and services in the European single market: overview and examples, (Academic Network of European Disability Experts), janar 2013 <http://www.disability-europe.net/theme/accessibility>

Gjermane. Ligje, akte të barazisë janë në nivel nacional por edhe në nivele federale. Sa i përket qasjes dhe largimit të barrierave fizike për lëvizjen e pa pengesë të komunitetit PAK, këtu do t'i nenvizojmë si mëposhtë:

- Seksioni 8, paragrafi 1 i dekretit për Barazinë e PAK [Gesetz zur Gleichstellung behinderter Menschen – Behindertengleichstellungsgesetz, BGG] përcakton në nivel kombëtar që të gjitha ndërtesat publike duhet të jenë të qasshme; ky obligim është i zbatueshëm për ndërtesa të reja dhe punë rindërtuese të ndërtesave publike në shkallë të madhe. Të gjitha 16 shtetet federale [Länder] i kanë ligjet dhe rregulloret e ngjashme për qasje në ndërtesa të cilat janë të hapura për publikun.

Po ashtu, këtu duhet të përmendim edhe transportin publik, i cili rregullohet si vijon:

- Seksioni 8 paragrafi 2 i Aktit për Barazi për PAK [Gesetz zur Gleichstellung behinderter Menschen – Behindertengleichstellungsgesetz, BGG] përcakton në nivel nacional që transporti publik duhet të jetë i qasshëm. Ky ligj ka bërë ndryshime në ligjet specifike që e prek qasjen në transport publik. Sipas raportit të ANED-it, pritjet që i gjithë transporti publik në Gjermani të jetë i qasshëm deri në vitin 2022. Autobusët që udhëtojnë në distanca të gjatë do të jenë të qasshëm deri në vitin 2019.

Suedia

Ligji për planifikim dhe Ndërtim i vitit 2010 i vendos rregullat e përgjithshme për mjedisin e ndërtuar. Në vendet tashmë të ndërtuara, mjedisi duhet të adaptohet për t'iu përshtatur njerëzve me kapacitet të limituar për të lëvizur dhe orientuar. Ligji për planifikim dhe Ndërtim përmban obligimin për t'i larguar barrierat lehtë të mënjanueshme në hapësira publike, duke e bërë të mundshme qasjen e komunitetit të PAK. Kjo kornizë rregulluese i obligon si pronarët publikë ashtu edhe ata privatë të ndërtesave. Në rreg-

ulloren 2011/338 mbi planifikim dhe ndërtim (Plan – och byggförordningen³³) përcaktohen edhe kërkesat që duhen përmbushur në ndërtim. Produktet që përdoren për ndërtim, monitorim, kontroll dhe ekspertizë. Për më shumë, ligji i prokurimit (SFS 2007/1091³⁴) thekson që specifikimet teknike duhet t'i marrin parasysh kërkesat e komunitetit të PAK apo duhet të jenë sipas parimeve të Design for all.

Në Suedi, e drejta për qasje në transport publik për PAK është vendosur në vitin 1979 me anë të një ligji special të transportit si dhe në rregulloren pasuese të vitit 1980, i cili ia alokon këtë përgjegjësi administratës suedeze të transportit (Trafikverket), administratës suedeze të lundrimit (Sjöfartsverket) dhe agjencisë suedeze të transport (Transportstyrelsen) për të iniciuar, planifikuar dhe monitoruar qasjen në transport publik. Këto autoritete janë po ashtu përgjegjëse për hartimin e rregulloreve mbi qasjen në bashkëpunimin me autoritetet e involvuara, ofruesit e transportit, organizatat e PAK, etj.

Italia

Ligjet me mërëndësi për t'u theksuar këtu janë: Dekreti 114 i Ministrisë së Artit dhe Kulturës më 16 maj 2008 që përmban udhëzuesin për eliminimin e barrierave arkitektonike në vendet e interesit kulturo; Ligji nr. 41 i vitit 1986 (Akti financiar 1986) që kërkon nga autoritetet lokale, zyrat shtetërore dhe regjionale që të adoptojnë plane për largimin e barrierave arkitektonike dhe që të alokojnë një pjesë të buxhetit të tyre vjetor për këtë qëllim; Dekreti Presidencial Nr. 503 i vitit 1996 që rregullon largimin e barrierave arkitektonike në ndërtesa publike në veçanti duke iu referuar qasjes në shërbime, si dhe ligji nr. 104 i vitit 1992, në disa paragrafë të këtij ligji të përgjithshëm që merren me bar-

33 http://www.riksdagen.se/sv/dokument-lagar/dokument/svensk-forfattningssamling/plan--och-byggforordning-2011338_sfs-2011-338

34 <http://www.notisum.se/rnp/sls/lag/20071091.htm>

rierat arkitektonike, vënë në pah respektin për qasjen në fusha të ndryshme (shëndetësi, arsim, trajnim, punësim, transport, drejtësi, etj.).

Dekreti i Presidentit të Republikës DPR, nr. 503 i vitit 1996 mundëson që mjetet për transport publik, tramvajët, trolejbusët, autobusët, linjat e autobusëve, metrot, trenat, hekurudha, shërbimet lundruese, terminalët ajrore duhet të jenë të pajisura me shtigje, rampa, a pajisje të tjera ngritëse për të lehtësuar qasjen me karroca për PAK.

Kroacia

Si pjesë e Strategjisë kombëtare për mundësitë e barabarta të PAK 2007-2015 është ofrimi i qasjes në transport publik për PAK: në të gjithë linjat ndërrbane në të cilat një gjë e tillë nuk është bërë deri më tani. Autobusët, anijet, trenat dhe tramvajët vazhdimisht adaptohen për qasje për komunitetin e PAK.

Qasja për PAK në ndërtesa rregullohet me ligjin e ndërtimit (Official Gazette 153/2013) dhe përmes akteve nënligjore që sigurojnë qasje në ndërtesa për PAK (Official Gazette 78/2013). Ky i fundit përfshin të gjitha objektet publike dhe biznesore, dhe ndërtesat e banimit. Kontrollimi i implementimit të këtyre neneve bëhet në të gjitha fazat e ndërtimit që nga projektimi, ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja. Aplikohen dispozitat penalizuese për mos zbatimin e dispozitave të qasjes për projektuesit, ndërtuesit, mbikëqyrësit e ndërtimit dhe pronarin e ndërtesës. Një nga masat e strategjisë kombëtare për barazim të mundësive për PAK 2007-2015 është obligimi i administratës shtetërore dhe atyre lokale që t'i shënojnë fondet, si dhe të raportojë për paratë e shpenzuara për heqjen e barrierave arkitektuale (Art. 2.6.4). Ministria e Familjes, dhe çështjeve të Veteranëve (sot Ministria e Politikave Sociale dhe Rinisë) në bashkëpunim me UNDP kanë nisur iniciativën për nënshkrimin e Kartës për qasjen në hapësira publike për PAK (nga shtatori 2009).

Sllovenia

Neni 16 i Aktit të Barazimit të Mundësive për PAK 2010 përmban dispozita për qasjen në transportin publik (rrugë, hekurudhë dhe trafikun detar). Sipas tij, ky është një obligim shteti, komune, dhe i ofruesve të transportit publik. Ky akt parasheh 10 deri 15 vjet periudhë tranzicioni, që do të thotë që qasja në transport për PAK do të bëhet e drejtë tek në vitin 2025.

Qasja në mjedis të ndërtuar është subjekt i Ligjit të ndërtimit i cili ka qenë në përdorim prej vitit 2003 (neni 17 i këtij ligji ka dispozita për qasje në mjedis të ndërtuar për PAK), si dhe në aktin e planifikimit hapësinor të vitit 2003. Standardet më të detajuara janë ato për qasjen në ndërtesa janë standardet Slovene SIST ISO /TR 9527 –dhe rregulloret për kërkesat për sigurimin e hyrjeve të qasshme dhe shfrytëzimit të ndërtesave publike dhe njësisve më të mëdha banesore.

Sipas nenit 17 në aktin të ndërtimit, të gjitha ndërtesat e reja të shfrytëzimit publik dhe ato që do të renovohen janë të obliguara që të ofrojnë qasje pa barrierapër PAK; qasja në katet më të larta duhet të jetë përmes liftave ose mjeteve të ngjashme, sidhe njësitë shumëbanesore duhet të kenë së paku 10% nga numri i përgjithshëm i banesave dhe të gjitha hapësirave të përbashkëta të qasshme për PAK. Sipas Aktit për barazimin e mundësive për PAK i vitit 2010, të gjitha ndërtesat në Slloveni duhet të jenë të qasshme për PAK deri në vitin 2025, si dhe parashihen penalizime për mos implementimin e këtij ligji.

Maqedonia

Projektimi i parkingjeve për PAK rregullohet me ligjin për sigurinë në trafik, i cili përcakton 3-5% nga numri i përgjithshëm i parkingjeve duhet të jenë për PAK. Standardet për këtë janë të përvijuara në Rregulloren për sigurimin e qasjes, lëvizjes dhe punës së PAK.

Qasja për PAK rregullohet me disa rregullore ligjore. Ligji i Ndërtimit (neni 11) i obligon të

gjithë ndërtesat publike dhe të banimit që të jenë të qasshme për PAK. Çdo njësi shumë-banesore që ka më shumë se 10 apartamente duhet të ketë një apartament komplet të qasshëm për PAK. Artikulli 34 i këtij ligji thekson se qasja në dhe prej ndërtesë nuk konsiderohet ndërtim (andaj edhe procedurat administrative edhe kërkesat teknike për realizimin e qasjes janë me të zvogëluara). Të njëjtat kërkesa janë edhe për ndërtesa historike dhe të trashëgimisë kulturore. Ligji për planifikim urban ka 2 akte nënligjore të cilat i përkufizojnë standardet dhe masat për qasjen e PAK. Disa segmente të qasjes për PAK rregullohen me ligjin për banim dhe ligjin për vetëqeverisje.

3. Praktikat e mira

3.1. Berlin – Design for all³⁵ (Berlini – Dizajni për të gjithë)

Administrata e qytetit të Berlinit së bashku me shoqërinë civile në vitin 2011/2 ka botuar një udhëzues gjithëpërmbljedhës për ndërtim pa barriera. Ky udhëzues është dokument obligues për të gjitha ndërtimet publike në qytetin e Berlinit. Udhëzuesi është i thjeshtë për përdorim dhe përbëhet prej dy publikimeve. I pari ka të bëjë me ndërtesa publike, ndërsa i dyti me hapësirat publike në qytet. Këto udhëzues janë nën autoritetin e Departamentit të Senatit për Zhvillim Urban dhe të Mjedisit, ndërsa, akterët kryesorë të tij janë sektori publik dhe privat (kompanitë e ndërtimit dhe arkitektët). Një nga qëllimet e tij është që të përditësojnë kodin e ndërtimit. Ky dokument përmbledh parimet bazë sipas filozofisë së Design for all për gjithë procesin planifikues.

Parimi bazë në të cilin bazohet ky udhëzues është Dizajni për të gjithë, pra promovimi i një koncepti dizajnues i cili i përshtatet nev-

ojave të të gjithë komunitetit pa dallim aftësie. Po ashtu, ky koncept mëtohet të jetë pjesë integrale e proceseve administrative, planifikuese dhe implementuese. Sipas Zero project, qysh një dekadë para se të hartohej ky udhëzues, Berlioni ka punuar në komisione për ndërtim dhe transport bashkë me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara (përfshirë këtu komisionerë me aftësi të kufizuara, organizata që përfaqësojnë të drejtat e këtij komuniteti dhe me borde këshilldhënëse për PAK³⁶.

Pikat themelore që i karakterizojnë këta udhëzues janë:

- Kërkesat e përgjithshme për qasje pa barriera: qasje dhe orientim dhe informim, sistemet informativ, ndriçimi, akustika, etj.
- Qasja publike që përfshin transportin publik.
- Fushat funksionale në ndërtesë dhe informatat në lidhje me: hyrjet, rrugët e evakuimit, vendet e tubimeve publike, hapësirat e zyreve, sanitarjet, garderobat, etj.
- Elementet funksionale të ndërtesës: shtigjet, hapësirat e parkimit, rampat, shkallët, liftat, dyert, muret, tavanet, dyshemetë, etj.
- Ndërtesat e caktuara për shfrytëzim publik dhe vendet për tubime publike: hapësirat për sport, kulturë, teatro, kinema, salla koncertale; hapësira të ekspozimit, hotele, arsimit, shkollat.

Ndërsa udhëzuesi për Hapësira Publike mbulon edhe :

- Elementet strukturore: dizajnin e sipërfaqeve, shkallët, sipërfaqet e pjerrta dhe rampat, etj.
- Elementet e tjera strukturore: pajisjet, sistemi orientues dhe informues, vendet për pushim, ndriçimi, hapësirat për

35 <http://www.stadtentwicklung.berlin.de/bauen/barrierefreies-bauen/de/handbuch.shtml>

36 Mandatory Barrier-free Construction in Berlin, <http://zeroproject.org/policy/berlin/>

shfrytëzim të përkohshëm, etj.


- Hapësirat publike të përzgjedhura: mjedise të gjalla, parqe, hapësira për lojë të fëmijëve, etj.³⁷

Secili projekt i konzorciumeve publike në Berlin, duhet t'i marrë parasysh kërkesat për qasje për komunitetin PAK. Të gjitha kontratat për punë publike duhet të përfshijnë obligimin për të zbatuar kërkesat nga të dy udhëzuesit, si dhe për hartimin e konceptit të qasjes për PAK. Për ndërtime të mëdha, konsultohet komisioneri për PAK ose zyra për ndërtim qasës, e cila për këtë qëllim gjendet në bashkinë e qytetit të Berlinit. Për ndërtesa të reja dhe zgjerime, dhe ndërrim funksioni, si dhe modernizime komplete të ndërtesave, koncepti pa barriera duhet domosdoshmërisht të përqafohet.³⁸

3.2 Trashëgimia e Berlinit për të gjithë

Qyteti i Berlinit, kishte ligjin e parë të trashëgimisë (1999) në të cilin thuhet se në të ardhmen, autoritetet e trashëgimisë duhet të konsiderojnë çështjen e qasjes për PAK në të gjitha vendimet e tyre⁴⁰. Autoritetet për mbrojtjen e monumenteve në qytetin e Berlinit theksojnë që duke i marrë parasysh kërkesat për mbrojtjen e ndërtesave të trashëgimisë, çështjet e qasjes së PAK në to duhet të balancohen me shqetësimet e mbrojtjes së trashëgimisë konform ligeve në fuqi.

Bazuar në atë që u tha më lart, autoritetet e monumenteve të Berlinit avokojnë për qasjen e PAK në ndërtesat dhe të mirat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore. Sipas Anna Maria Odenthal nga autoritetet e mbrojtjes së mon-



Diagrami i procesit të hartimit të planeve dhe projekteve sipas konceptit Design for all³⁹

umenteve të qytetit të Berlinit, meqë ndërtesat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore janë dëshmi unike të historisë të kulturës dhe arkitekturës, si dhe duke u bazuar në interesin e gjerë publik, nuk mund të propozohet një standard i vetëm i vlerësimit dhe i intervenimit që ndërtesat e trashëgimisë të bëhen më të qasshme për komunitetin PAK. Sipas saj secila ndërtesë duhet të ekzamino-

³⁷ Po aty

³⁸ "Barrier-free Concept" Instructions, Accessible Public Buildings, Berlin Design for all, Senate Department for Urban Development and the Environment, maj 2015, http://stadtentwicklung.berlin.de/bauen/barrierefreies_bauen/de/handbuch.shtml

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Udhëzuesi për vlerësim konservues të masave ndërtimore në mënyrë që të respektohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe brengat e njerëzve me mobilitet të zvogëluar në lidhje me procedurat autorizuese të ligjit për trashëgiminë kulturore sipas § 11 (6) Ligji i trashëgimisë i Berlinit, 24 prill 1995 (GVBl, fq. 274), me përditësim të fundit me nenin II të ligjit, 8 korrik 2010 (GVBl, fq. 396).

het me kujdes, që të kuptohet se në cilën shkallë intervenimi që do të përmirësojë qasjen do të ketë impakt në vlerat e ndërtesës.⁴¹

Sipas Anna Maria Odenthal, autoritetet e Berlinit për mbrojtjen e monumenteve kanë një set pyetjesh që i shfrytëzojnë në ekzaminimet rast për rast në situatat kur këto ndërtesa propozohen që të bëhen më të qasshme për PAK. Pyetjet janë të ndërlidhura kryesisht me vlerësimin se cilat pjesë të ndërtesës kanë vlerë më të lartë për t'u mbrojtur; çfarë dëmi mund të ketë një intervenim i caktuar në ndërtesën e mbrojtur; a ekzistojnë intervenime alternative që ndërtesën e bëjnë të qasshme, e që në vetvete janë krejtësisht apo pjesërisht të kthyeshme; a mund të përdoren instalimet mobile si zgjidhje të përkohshme, përdërisa kërkojnë zgjidhjet finale; cilat janë kërkesat e komunitetit PAK në lidhje me qasjen në ndërtesat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore, dhe cilat nga këto kërkesa nuk mund të refuzohen, etj.

Në këtë frymë në vitin 2013, autoritetet e mbrojtjes së monumenteve të qytetit të Berlinit në bashkëpunim me Universitetin Teknik të Berlinit, organizuan një ekspozitë shëtitëse⁴², me punën e 50 studentëve të arkitekturës, të cilët gjatë një viti kishin studiuar dhe hulumtuar mënyrat se si 3 nga monumentet më të rëndësishme të Berlinit⁴³ të bëhen më të qasshme për komunitetin e PAK. Krahas punës dhe zgjidhjeve kreative se si ndërtesa e trashëgimisë të bëhet më e qasshme, Universiteti kishte përzgjedhur edhe mënyrën e prezantimit me modele tridimensionalengriturat ngritura dhe me materiale taktile, për të bërë projektet më të qasshme për përdorues karrocash si dhe për

komunitetin e verbër. Sipas autoriteteve të monumenteve në Berlin, monumentet, përkatësisht kishat dhe muzetë duhet të jenë të gjalla sepse ato janë ndërtuar për njerëz. Ato mund të kryejnë funksionin e vet vetëm nëse janë të qasshme dhe mund të përjetohen nga të gjithë.

3.3. Access City Award⁴⁴

Me qëllim të promovimit të qasjes për PAK në qytetet e Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian, çdo vit ndan çmimin Access City Award. Përmes këtij çmimi, mëtohet të sigurohet dhe celebrimet përprjekja e qyteteve evropiane për të garantuar qasje të barabarta për të gjithë në të drejtat fundamentale, si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për gjithë popullatën, pavarësisht, moshës, gjinisë dhe aftësisë. Ky çmim është i hapur për të gjitha qytetet e Bashkimit Evropian që kanë mbi 50.000 banorë.

Çmimi Access City Award është një veprim përmes të cilit Komisioni Evropian përpiqet të sigurojë qasje të barabartë si dhe një përjetim të plotë të jetës urbane për komunitetin e PAK. Qytetet që tashmë kanë pasur fatin të shpërblehen me këtë çmim për zgjidhjet inovative, por edhe për shkallën e qasjes për PAK në shërbimet dhe infrastrukturën e qytetit janë: Milano, Tuluzë, Kaposvahr, Vaasa (2016); Boras, Helsinki, Lubjana, Arona, Budapest (2015), etj.

3.4. Udhëzuesi për implementimin e projektit “Qasja në trashëgiminë kulturore për komunitetet vulnerabël” – Slloveni⁴⁵

Në vitin 2014, në Lubjanë u publikua Udhëzuesi për implementimin e projektit “Qasja në trashëgiminë kulturore për komunitetet vulnerabël”, e realizuar nga Muzeu Etnografik i Sllovenisë, dhe i financuar nga Bashkimi Evropian, përkatësisht nga Fondi

41 Odenthal, A., M., Barrier-free Access and Use of Architectural, Archaeological and Garden, Monuments, Publikimi: Cultural Heritage and Barrier-free Accessibility-Guideline and Student Project, Senate Department for Urban Development and the Environment, Berlin, 2014

42 Publikimi: Cultural Heritage and Barrier-free Accessibility-Guideline and Student Project, Senate Department for Urban Development and the Environment, Berlin, 2014

43 Galeria Neue Nationalgalerie, Katedralja St Hedwig dhe Altes Stadthaus

44 Çmimi për qytetin më të qasshëm
45 <http://www.dostopnost.eu/>

Social Evropan, si dhe Ministria e Kulturës e Sllovenisë.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të analizohen dhe të gjenden zgjidhje për rritjen e qasjes së grupeve të marginalizuara në përmbajtjet muzeale në Slloveni. Koncepti i këtij projekti bazohet në parimin e muzeut

izuara; aktivitetet dhe projektet në programet për grupet vulnerabël; problemet dhe zgjidhjet e sugjeruara në zbatimin e programeve; mundësitë hapësinore ekzistuese dhe pajisje që mundësojnë qasje më të mirë në informata për koleksionet muzeale për personat që u përkasin grupeve vulnerabël, etj.



gjithëpërfshirës nga fundi i shekullit të 20, që vjen nga bota anglo-amerikane, sipas të cilit, të gjithë duhet të kenë qasje në të gjitha nivelet e muzeve. Përmes këtij projekti, fillimisht, duhet siguruar qasja fizike në koleksionet dhe aktivitetet që zhvillohen në muze për të gjithë vizitorët, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual, besimi fetar, origjina etnike, prejardhja sociale ose ekonomike, si dhe aftësia. Përveç kësaj, në muzeun gjithëpërfshirës promovohen aktivitete, ekspozita që përfaqësojnë diversitetin e vizitorëve, duke përfshirë këtu grupet e marginalizuara etj. Udhëzuesi është i ndarë në 7 kapituj dhe fillimisht jep një analizë të problematikës së qasjes në 10 muze të shtetërore në Slloveni. Qasja analizohet nga aspekti i qasjes fizike, të komunikimit dhe të sistemit të informatave për komunitetet e caktuara me aftësi të kufizuara; çështja e punësimit të personave që i përkasin këtyre grupeve të marginal-

Foto: Muzeu etnografik i qashtëm, Lubljanë, Slloveni. www.etno-muzej.si

Po ashtu në udhëzues paraqitet edhe një analizë e situatës së papunësisë të personave që u përkasin grupeve vulnerabël; problemet me të cilat përballen këto grupe, dhe sugjerohen zgjidhje për të rritur punësimin e tyre. Një pjesë tjetër i kushtohet përshkrimit të opsioneve hapësinore dhe pajisjeve të posaçme për të aftësuar personat nga grupet vulnerabël për të punuar si kuratorë a ngjashëm në muze.

3.5. Mësimet nga Italia

Udhëzuesi për parqet për të gjithë⁴⁶

E drejta për të mos u përjashtuar nga asnjë vend...

Bazuar në premisën se tashmë është arritur momenti kulturor kur hartimi dhe futja në fuqi e normave dhe rregulloreve të reja për eliminimin e barrierave nuk nënkupton krijimin e mjeteve të reja për penalizimin e të papërgjegjshmëve, por është një përpjekje për të rritur mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim, në vitin 2003, Associazione ACLI Anni Verdi dhe Ministria e Mjedisit dhe e Mbrojtjes së Territorit të Italisë publikuan projektin Parqet për të gjithë – shfrytëzueshmëri për shfrytëzim më të gjerë. Objektivi i këtij projekti është promovimi i shfrytëzimit të zonave të mbrojtura natyrore nga të gjithë qytetarët. Por, edhe fuqizimi i autonomisë së secilit qytetar, duke i lejuar qasje të lehtësuara dhe shfrytëzim të gjithë habitatit në të cilin zhvillohet jeta. Objekt i kësaj rregulloreje janë mjediset e mbrojtura natyrore, parqet kombëtare dhe të ngjashme.

Disa nga direktivat bazë që gjenden në këtë udhëzues janë:

- Garantimi i mundësisë së arritjes me makinë personale dhe parkimit në afërsi të pikave të interesit.
- Garantimi i qasjes dhe arritjes për fëmijë, pleq dhe PAK, së paku në të gjitha strukturat publike të parkut kombëtar
- Realizimi i shtigjeve kryesore këmbësorike duke i projektuar në bazë të parametrave të gjatësisë, gjerësisë, pjerërtësisë, tipologjive të terrenit konform nevojave të shfrytëzuesve
- Identifikimi i shtigjeve të preferuara të pajisura për të mundësuar mobilitet dhe orientim të personave të verbër, apo me

shikim të dëmtuar.

- Pajisja me makina të vogla elektrike për tejkalimin e distancave të mëdha
- Komunikim dhe informim adekuat në lidhje me qasjen në struktura dhe pjesë të parkut.



Udhëzuesi për kapërcimin e barrierave arkitektonike në vendet e interesit kulturor⁴⁷

Lidhja e ngushtë ndërmjet monumentit dhe shfrytëzimit është garancia më e mirë për konservimin e trashëgimisë⁴⁸ (...)

Parimet themelore të qasjes janë pjesë integrale në një projekt të konservimit, dhe përfshihen në termin “Konservim të integruar”. Në këtë udhëzues për qasje në trashëgimi kulturore, i cili u hartua në vitin 2008, theksohet se instancat e qasjes duhet të konsiderohen si elementet normale të projektit, sikurse siguria, stabiliteti i strukturës, komforti termik dhe i lagështisë, normat ndërtimore dhe urbane, apo edhe parimet e restaurimit,

47 https://www.beniculturali.it/mibac/multimedia/MiBAC/documents/1311244354128_plugin-LINEE_GUIDA_PER_IL_SUPERAMEN-TO DELLE BARRIERE ARCHITETTONICHE.pdf

48 Carbonara, G. Teoria e metodi del restauro, 1996, marrë nga line guide per il superamento delle barriere architettoniche nei luoghi di interesse cultural, marrë nga Linee guida per il superamento delle barriere architettoniche

46 http://www.minambiente.it/sites/default/files/archivio/biblioteca/dpn_linee_guida_parchi.pdf

si autenticiteti, reversibiliteti, kompatibiliteti, etj. Përmirësimet ndërtimore për të siguruar qasje sot duhet të shihen si domosdo e kohës, dhe si kusht progresiv dhe kritik i restaurimit, meqë intervenimi ka për qëllim të përmirësojë shfrytëzueshmërinë e ndërtesës për të ardhmen⁴⁹.

Një nga kriteret më të ndjeshme të projekteve restauruese është çështja e reversibilitetit të intervenimeve ndërtimore në ndërtesat e trashëgimisë. Ky aspekt garanton kujdesin ndaj ndërtesës, meqë lejon kthimin në gjendjen origjinale, pa dëmtuar veprën. Edhe në aspektin e intervenimeve përmirësuese të qasjes për PAK, përkohshmëria e intervenimit duhet të jetë një nga parimet të panegociueshme.



Foto: Rampa në pallatin e senatorëve, Campidoglio, Romë

⁴⁹ Carbonara, G., testo della lezione tenut al corso post-lauream "Progettare per tutti senza barriere, Roma 2002, marrë nga Linee guida per il superamento delle barriere architettoniche

Në udhëzues jepen disa kriteret për projektim restaurues dhe menaxhim të ndërtesave/ lokaliteteve historike për të qenë të qasshme për të gjithë. Më poshtë janë të përshkruara disa më karakteristiket:

- Orientimi – të përvetësohen strategji të veçanta që favorizojnë orientimin për personat që e kanë të vështirë orientimin në hapësirë. p.sh. të parashihen pika apo linja referuese; projektim i sinjalistikës së përshtatshme, hartat e qasshme, etj.
- Sinjalistika – sinjalistika informative, që vendoset në hyrjen kryesore dhe në pikët tjera strategjike në ndërtesë. Kjo sinjalistike zakonisht shoqërohet me harta. Sinjalistika drejtuese – shenja, shigjeta që tregojnë drejtimet, që vendosen në shtigje dhe kryqëzime. Sinjalistika identifikuese – që shërben për identifikimin e vendit apo ndërtesës, etj.
- Hartat e qasshme
- Kapërcimi i distancave – te të gjitha shtigjet me gjatësi më shumë se 50 m parashihet vende për ulje/ pushim, me mobiluar për ulje dhe mbështetje.
- Dyshemetë – parashihen dy strategji për bërjen e dyshemeve historike më të qasshme. Në njërin parashihet largimi i pjesshëm i disa pjesëve të saj dhe zëvendësimi me materiale reversible. Në rastin e dytë, vendosja e shtroja jo të rrëshqitshme, të cilat po ashtu mund të japin drejtim për të lehtësuar lëvizjen për personat që e kanë problem orientimin.
- Kapërcimi i disniveleve – propozohen 4 sisteme të ndryshme: rampa, lifti, platforma ngritëse ose platforma palosëse, etj.

Intervenimet tjera që propozohen në këtë udhëzues janë: adaptimi dhe përmirësimi i shkallëve dhe rampave, ekzistuese; intervenimet në shkallë urbane dhe peizazhiste; shërbimet higjienike të qasshme; organizimi i brendshëm të mos pengojë qasjen fizike; dizajni i brendshëm i hapësirave ekspozuese të jetë për të gjithë; parkimi i qasshëm; didaskaliet; ndriçimi; qasja në pikat informative; pajtueshmëria me normativat e sigurisë

dhe mbrojtjes kundër zjarrit, etj.

Në fund të udhëzuesit bëhet ilustrimi i disa intervenimeve që e përmirësojnë qasjen fizike përmes rasteve studimore.

Citta per tutti – Venezia Accessibile⁵⁰ (turizmi për të gjithë)

Në konferencën e Design for all në Milano, në vitin 2007, u hartua karta e Milanos, me titull “Turizmi për të gjithë”,⁵¹ në të cilin, mes tjerash u deklarua se Design for all ka potencial për të krijuar kushte që të gjithë të gëzojnë turizmin dhe kohën e lirë, në mënyrë aktive dhe pasive.

Qyteti i Venedikut ka disa vjet që ka themeluar një shërbim komunal (Citta per tutti), i cili angazhohet për të garantuar qytetarëve të vet, dhe turistëve me aftësi të kufizuara informata për shfrytëzimin më të mirë të shërbimeve dhe qytetit në përgjithësi. Venediku si qytet ka një morfologji të veçantë meqë përbëhet nga 121 ishuj të lidhura mes veti përmes 435 urave që e bënë këtë qytet shumë të vështirë për t’u shfrytëzuar nga shumë grupe të komunitetit, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, prindër me karroca, turistët me valixhe, etj.

Falë një politike efikase të transportit publik dhe intervenimeve përmirësuese në ndërtesa dhe qytet të bëra nga Administrata komunale në vitet e kaluara, qasja fizike në qytet është shumë më e kënaqshme. Përgjatë viteve, komuna e Venedikut ka zhvilluar disa materiale informative dhe paketa me itinerar të qasshëm turistik. Ndër materialet që i ka zhvilluar komuna, janë kartolinat taktile, harta taktile, paketën Venediku i qasshëm, që përmban 13 itinerare turistike pa barriera për turistë që kanë aftësi të kufizuara motorike, dhe informa-

ta për qasje në barriera të veçanta, etj.

Qendra historike e Venedikut shihet si një barriera e madhe arkitektonike, mirëpo në realitet 70% e saj është e qasshme për persona me aftësi të kufizuara motorike. Mjetet e qasshme të transportit publik mundësojnë qasjen deri te monumentet më të pasura në qytet.



Foto: Harta e zonave të qasshme për PAK në qendrën historike të Venedikut

Në zonat e gjelbra qasja për PAK është e mundur përmes barkave dhe motoskafeve të qasshme. Pjesët e bardha janë të paqasshme me transport publik, mirëpo ekziston mundësia e qasjes përmes marrjes me qira të barkave të veçanta.

Zyra për eliminim e barrierave në komunën e Venedikut, ka realizuar hartën e Venedikut të qasshëm, e cila përmban një numër shumë të madh të informatave për qasjen në qytet për vizitorë me aftësi të kufizuara motorike. Si dhe prapa hartës ekzistojnë informatat për pikat informative në qytet, pikat e ndaljes së transportit publik, parkingjet, etj.

⁵⁰ Qyteti për të gjithë – Venediku i qasshëm <http://www.comune.venezia.it/archivio/589>

⁵¹ <http://dfaeurope.eu/what-is-dfa/dfa-documents/the-milan-character-2007/>



Foto: Harta e zonave të qasshme për PAK në qendrën historike të Venedikut

IV. PASQYRË E PROBLEMEVE THEMELORE NË MJEDISIN E NDËRTUAR NË PRIZREN

Në këtë seksion janë të përmbledhura një numër i problemeve dhe brengave të komunitetit të PAK, nga disa raporte të publikuara nga EC Ma Ndryshe⁵², anketime dhe nga diskutime me komunitetin PAK të qytetit të Prizrenit.

- Mungojnë tualetet publike të projektuara me parametrat teknikë të përshtatshëm për shfrytëzim nga përdorues të karrocave, por edhe në lokale të shërbyese dhe ndërtesat publike.
- Personat me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi të shfrytëzimit të hapësirave publike.
- Personat me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi të qasjes në objektet sportive dhe kulturore.
- Qasja në objekte shëndetësore është mjaft e vështirësuar, meqë ka barriera fizike për përdorues karrocash, por edhe barriera komunikimi, meqë mungojnë interpretë të gjuhës së shenjave për perso-

⁵² Pjesa më e madhe e problemeve dhe rekomandimeve të përmbledhura dhe cekura në këtë seksion janë bazuar në artikullin e autores Pallaska O'Shaughnessy, D., Personat me aftësi të kufizuara dhe planifikimi urban në Prizren Arsimi, Shëndetësia dhe Punësimi, Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në qytetin e Prizrenit, EC Ma Ndryshe 2014

http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/150126113634_Qyteti_Gjithperfshtires_2014.pdf

Basha, R., Personat me nevojat e veçanta dhe planifikimi urban në Prizren – Qasja publike, grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në qytetin e Prizrenit, EC Ma Ndryshe, 2013

http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/Qyteti_Gjithperfshtires.pdf

Basha, R., Analizë e shkurtër, Planifikim urban për qytetarët 4, EC Ma Ndryshe, dhjetor 2015

Basha, R., Analizë e shkurtër, Planifikim urban për qytetarët 3, EC Ma Ndryshe, tetor 2014, http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/150203145824_EC_Planifikim_Urban_per_Qytetaret.pdf

Basha, R., Analizë e shkurtër, Planifikim Urban 2 për Qytetarët, EC Ma Ndryshe, dhjetor 2013

Basha, R., Analizë e shkurtër, Planifikim Urban për Qytetarët, EC Ma Ndryshe, shtator 2013, http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/ANALIZA_Planifikim_urban_per_qytetaret.pdf



na të shurdhër, etj.

- bllokimi i trotuareve nga veturat, malli i ekspozuar, mobiliari i kafeterive, reklamave, duke pamundësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve në përgjithësi dhe të qytetarëve me aftësi të kufizuar në veçanti (shfrytëzuesit e karrocave, personat e verbër, shfrytëzuesit e shëtitoreve);
- mungesa e plotë e rampave, apo rampa me pjerrtësi të papërshtatshme për shfrytëzuesit e karrocave në shkolla, banka, sallën e sportit, shtëpinë e kulturës, dhe objekte të tjera publike;
- mungesa e sipërfaqeve taktore dhe shenjëzimi me ngjyra kontraste të forta për të mundësuar lëvizjen e të verbërve, dhe të personave me shikim të dobësuar;
- mungesa e plotë apo zënia nga të tjerët e parkingjeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar në afërsi të Kuvendit Komunal, Shtëpisë së Bardhë dhe ndërtesa të tjera publike;
- mungesa e ashensorëve, ose e ashensorëve funksionalë në shkolla, ndërtesën e Kuvendit Komunal, spital;
- tualetet e papërshtatshme për shfrytëzuesit e karrocave dhe shëtitoreve në

shkolla dhe objekte të tjera publike;

- transporti publik urban dhe ndërrurban i paqasshëm për shfrytëzuesit e karrocave dhe mjeteve të tjera ndihmëse për lëvizje;
- mungesa e hapësirave të përshtatshme për përdorues të karrocës në shtëpi të kulturës;
- gjerësia e shkallëve në objektet publike jo e përshtatshme për shfrytëzuesit e shëtitoreve, patericave apo të shkopit të bardhë;
- sportelet dhe bankomatet të vendosura në lartësi të madhe për personat shtatshkurtër apo përdorues të karrocës;
- ndriçimi i dobët në lagje të caktuara, veçanërisht për personat me të shikim të dobësuar.
- OJQ-të dhe agjencitë tjera nuk kanë politika të qarta për mjedisin pa barriera për lëvizjen e njerëzve.



Barrierat institucionale:

- mungesa e legjislacionit, legjislacioni diskriminues, moszbatim i ligjit,
- mospërfshirja e nevojave të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në planet zhvillimore komunale, planifikim buxhetor pa objektiva që adresojnë nevojat e qytetarëve me aftësi të kufizuara,
- mosalokimi i mjeteve të mjaftueshme buxhetore për të mbështetur shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, etj.
- mungesa e zbatimit të legjislacionit relevant veçanërisht gjatë ndërtimeve të reja (Ligji Nr. 04/L- 110 për Ndërtim, respektivisht Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara);
- mungesa e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara nga shtëpia deri në shkollë dhe anasjelltas (Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës);
- mungesa e buxhetit për ofrimin e shërbimeve të caktuara personave me aftësi të kufizuara (transportit, shëndetësore, komunale, etj.).
- Profesionistët të cilët merren me planifikim dhe projektim nuk kanë njohuri për detajet specifike, nuk i njohin edhe udhëzimet administrative që përcaktojnë parametrat për sigurimin e një mjedisi pa pengesa.

Barrierat në informim apo komunikim:

- mungesa e informatave në autobusët e transportit publik dhe në stacione në alfabetin Braille për persona të verbër, në format të lexueshëm lehtë për personat me aftësi të kufizuara intelektuale, me shkronja të mëdha të shtypit për personat me pengesa në shikim;
- mungesa e informacionit orientues në format të qasshëm në shtëpi të shëndetit, spital dhe gjeti;
- mungesa e shenjëzimeve adekuate në vendet e caktuara nëpër spitale, e objekte të tjera publike.



Më poshtë do të shënojmë disa nga rekomandimet praktike dhe udhëzuese për eliminimin e barrierave të përmbledhura më lartë, të nxjerra nga raporti Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në qytetin e Prizrenit⁵³, nga EC Ma Ndryshe:

- Të rritet pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje për qytetin
- Të mundësohet qasja në sistemet e zakonshme
- Të sigurohet financim i duhur për shërbimet për personat me aftësi të kufizuara
- Të aprovohet një strategji komunale për aftësi të kufizuara
- Të involvohen personat me aftësi të kufizuara në zhvillimin e qytetit
- Të përmirësohen kapacitetet e burimeve njerëzore lidhur me aftësinë e kufizuara

⁵³ Pallaska O'Shaughnessy, D., Personat me aftësi të kufizuara dhe planifikimi urban në Prizren Arsimi, Shëndetësia dhe Punësimi, Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në qytetin e Prizrenit, EC Ma Ndryshe 2014 http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/150126113634_Qyteti_Gjiitheperfshires_2014.pdf

dhe parimet e të drejtave të njeriut.

- Të rritet vetëdijesimi publik dhe të kuptuarit për aftësinë e kufizuar

1. Përmbledhje e problemeve nga fokus grupi me komunitetin e PAK

Në kuadër të këtij hulumtimi, më 20 maj 2016 në ndërtesën e Beledijes në Prizren, u mbajt një fokus grup me komunitetin e personave me aftësi të kufizuar, me qëllim që nevojat dhe problemet me të cilat ky komunitet përballlet përditë të identifikohen dhe shqyrtohen në analizë. Me këtë rast, të pranishëm ishin përfaqësues me aftësi të kufizuara motorike, shqisore dhe përfaqësues të organizatave që përfaqësojnë këtë komunitet.

Gjatë diskutimit dolën në pah para së gjithash, vështirësitë e këtij komuniteti për jetë të pavarur në qytetin e Prizrenit, që mes tjerash ishte pasojë edhe e mundësive të kufizuara për të lëvizur në mënyrë të pavarur në qytet dhe për t'iu qasur vetë ndërtesave publike dhe shërbimeve të tjera në qytet. Janë të shumta barrierat me të cilat ky komunitet përballlet përditë, që përpos atyre barrierave arkitektonike (fizike), përballlet edhe me barrierat në komunikim, mendësinë kulturore dhe problemet shoqërore, si dhe barrierat e krijuara nga moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Më poshtë janë të përmbledhura disa nga problemet kritike për lëvizjen e komunitetit PAK në qytet, të cilat u diskutuan në fokus grup:

- Mungesa e qasjes së personave me aftësi të kufizuar në transport urban,
- Mungesa e rampave për qasje në institucione publike,
- Mungesa e shenjëzimeve – sipërfaqeve taktore në trotuare, për persona të verbër,
- Uzurpimi i trotuareve nga shitësit reklamaf dhe makinat e parkuara.
- Mungesa e parkingjeve të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara.
- Sipërfaqet e trotuareve dhe rrugëve nuk janë të përshtatura për shfrytëzim për persona që shfrytëzojnë karrocën: te vendkalimet e rrugëve, trotualet nuk kanë rampë dhe nëse diku gjendet rampa, ajo nuk e ka të përshtatshme pjerrtësinë;
- Mungesa e shenjëzimit me ngjyra me kontraste të forta në dyscheme/trotuare, shkallë dhe shtyllëza për persona me aftësi të kufizuara pamore.
- Mungesa e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të trotuareve – mungojnë kubëzat, ekzistojnë gropat, etj., që pengojnë lëvizjen e personave me karrocë, etj.
- Ndërtimet e reja, publike apo edhe ato private që janë në shërbim të një publiku më të gjerë, nuk janë ndërtuar sipas standardeve që përshkruhen në udhëzuesin administrativ nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara.
- Gjerësitë e shkallëve, thellësia e basamakut, si dhe lloji i gardheve të shkallëve nuk janë sipas parametrave të përcaktuar me UA 33/2007.
- Mungojnë tualetet publike të qasshme për komunitetin PAK, në hapësira publike, në institucione komunale, kulturore, sportive, lokale shërbyese. Aty ku ekzistojnë, nuk janë të pajisura si duhet, ose kanë përmasa më të vogla dhe të papërshtatshme për shfrytëzim nga përdorues karrocash.
- Çështje që lidhet me mirëqenien sociale është edhe strehimi i këtyre familjeve. Janë të shumta familjet me një apo dy pjesëtarë me aftësi të kufizuara të cilët kanë parashtruar kërkesa për strehim në objekte shumëbanesore kolektive, etj.
- Qasja në objekte shëndetësore është mjaft e vështirësuar, meqë ka barriera fizike për përdorues karrocash.

V. UDHËZIME PËR APLIKIMIN E KONCEPTIT PA BARRIERA NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT DHE PROJEKTIMIT

1. Elementet strategjike për një mjedis pa barriera

Avokimi dhe ngritja e vetëdijes

Hapi i parë drejt rritjes së qasjes në mjedis të ndërtuar dhe rritjes së gjithëpërfshirjes sociale të komunitetit PAK është ndërrimi i mendësisë kulturor ndaj aftësisë së kufizuar si dhe i perceptimeve mbi këtë komunitet përbrenda shoqërisë. Personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat që mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e këtij komuniteti luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e avokomit, meqë i njohin më së miri nevojat e këtij komuniteti. Komuniteti PAK dhe organizatat e ndërlidhura me ta janë burimi kryesor i informatave për politikbërësit, planerët, arkitektët dhe agjencitë implementuese, rreth rrethanave që krijojnë barriera për ta. Një avokim i mirë e targeton një audiencë të gjerë nga komuniteti lokal, personat e tjerë me aftësi të kufizuara, profesionistë (arkitektë dhe planerë), zyrtarët kyç të pushtetit dhe politikanë, mediat dhe publikun e gjerë në përgjithësi.

Avokimi i mirë përfshin strategji të ndryshme, nga ofrimi i materialit informues rreth aftësisë së kufizuar për publikun e gjerë, takimet me aktorët kyç, përfshirjen e medieeve, evidentimi i barrierave arkitektonike përmes auditimit të mjedisit të ndërtuar, hartëzimi i barrierave për të pasur një pasqyrë të qartë të shtrirjes së problemit si dhe për të pasur propozime konkrete për largimin e tyre, lansimi i kampanjave kombëtare për qasjen e PAK në shoqëri.

Një element tjetër kyç mund të jetë trajnimi dhe arsimi i zyrtarëve komunalë mbi aspektet teknike të qasjes për komunitetin PAK në mjedisin e ndërtuar. Në veçanti për planerët dhe arkitektët që janë pjesë të dikastereve relevante tek autoritetet lokale, të cilat marrin vendime rreth projekteve të caktuara infrastrukturorë dhe ndërtimore në qytet, japin lejet dhe bëjnë pranime teknike si dhe janë pjesë të misioneve tenderuese.

Hartimi i politikave dhe zhvillimi i kuadrit ligjor

Siç u pa më lartë, vendi ynë tashmë i ka të formuluar objektivat strategjikë të gjithëpërfshirjes së komunitetit PAK në shoqëri në kuadër të kornizave të politikave të shtetit; udhëzuesi administrativ për kushtet teknike për qasjen e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e ligjit të ndërtimit, tashmë i vendos disa standarde teknike për ta bërë mjedisin e ndërtuar më të qasshëm. Duke qenë se globalisht kjo fushë po zhvillohet përditë e më shumë, duhet të bëhen përpjekje për të hartuar politika të reja si dhe zgjeruar dhe përditësuar ato të cilat tashmë janë. E drejta për qasje të komunitetit PAK në mjedis të ndërtuar më së miri sigurohet përmes kuadrit të mirë ligjor dhe politikave të qarta mbi qasjen e PAK. Formulimi i legjislacionit bëhet duke mobilizuar dhe siguruar mbështetjen e komunitetit, organizatat që përfaqësojnë interesat e PAK, personat kyç nga shoqëria civile, zyrtarë të pushtetit lokal, politikanë, arkitektë, planerë, etj.

Gjatë draftimit të politikave dhe legjislacionit mbi qasjen për PAK duhet të sigurohet një lexim dhe përgjigje e konsiderueshme publike në draft, por edhe kohë e mjaftueshme për komentime (ndoshta përmes komisioneve këshillëdhënëse, fokus grupeve, diskutimeve publike, diskutimeve në bashkësi lokale, lagje, etj.).

Sa i përket politikave të qasjes dhe legjislacionit, siç u cek edhe më lartë problemi kyç qëndron te zbatimi i tyre. Zbatimi i tyre

duhet të bëhet përmes mekanizmave të caktuar: p.sh. penalizimet dhe gjobat në rast të moszbatimit të tij, ose ofrimi i incentivëve për realizim të qasjes në ndërtesa dhe infrastruktura. I gjithë ky proces duhet të komplementohet me monitorimin e zbatimit, duke kërkuar angazhim nga pjesëtarë të komunitetit PAK dhe nga publiku i gjerë, për të vlerësuar ose denoncuar rastet e shkeljeve ligjore në zbatimin e legjislacionit për qasje në ndërtesa dhe infrastruktura.

Problemet kryesore të cilat duhet gjetur zgjidhje në këtë drejtim janë: monitorim i munguar dhe jo i mirë, si dhe mungesa e mekanizmave të zbatimit të këtij legjislacioni. Problem tjetër në këtë drejtim është mungesa e financimeve të mjaftueshme nga pushteti lokal për t'i adresuar çështjet e qasjes për PAK në mjedis të ndërtuar.

Sigurimi i burimeve dhe zgjidhjeve financiare

Siç u tha më lartë, mungesa e burimeve financiare si te pushteti lokal ashtu edhe e incentivëve për sektorin privat, paraqet një barrierë në vete, që pengon realizimin e projekteve që fillimisht kanë për qëllim largimin e barrierave ekzistuese arkitektonike në mjedis të ndërtuar, e pastaj edhe për zbatimin parametrave teknikë që parashihen me UA 33/2007, por edhe parametrave tjerë për realizimin e ndërtesave të reja të qasshme për komunitetin e PAK. Në këtë drejtim duhet siguruar financuesit, kompanitë ndërtimore dhe akterët e tjerë që janë të involvuar në ndërtimin e qytetit.

Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në vendimmarrjen për planifikimin e qytetit

Përkufizimi i nevojave dhe kërkesave themelore rreth qasjes në mjedis të ndërtuar është aspekt thelbësor për implementimin e suksesshëm të qasshmërisë. Prandaj është e rëndësishme që procesi i planifikimit të jetë proces me pjesëmarrje të komunitetit, meqë kështu do të përkufizohen kërkesat dhe elementet tjera të

cilat do të inkorporohen në projekt.

Planifikimi dhe implementimi i strategjive arkitektonike

Strategjitë dhe planet për implementimin e qasjes në mjedis të ndërtuar duhet të zhvillohen që të kenë efektivitet maksimal. Implementimi i strategjive për sigurimin e qasjes për PAK në ndërtesa në procesin e planifikimit duhet të përfshijë fazën para planifikimit; faza e miratimit dhe dhënies së lejes; faza e ndërtimit dhe monitorimi i tij në kantier dhe faza e mirëmbajtjes. Gjatë gjithë këtij procesi janë shumë aktorë të përfshirë, nga planerë, arkitektë deri të zyrtarët e autoriteteve lokale. Parimi themelor me të cilin garantohet qasja për PAK është përqafimi i konceptit projektues Dizajni for all. Me këtë garantohet një konsideratë e plotë e çështjeve që ndërlidhen me qasjen e PAK qysh nga faza konceptuale dhe e cila pastaj vazhdon të jetë evidente në fazat e projektimit, ndërtimit, etj. Një qasje e tillë siguron që ndërtesa e re të jetë e qasshme për PAK, por edhe kostoja për të arritur një mjedis/ ndërtesë të qasshme është e ulët.

Ndërsa, modernizimi i ndërtesave ekzistuese përmes përmirësimit të qasjes së saj për PAK, duke intervenuar me elemente qasëse zakonisht është më i kushtueshëm, por autoritetet duhet të zhvillojnë strategji të veçanta për largimin e tyre, si dhe të sigurojnë financim të duhur që mjedisi ekzistues të jetë më i qasshëm, meqë sikurse theksohet në American Disability Act, edhe moslargimi i barrierave arkitektonike konsiderohet si shkelje e të drejtave elementare njerëzore.

2. Rekomandimi për hartimi i manualit për projektim pa barriera

Qëllimi dhe audiencia të cilës duhet t'i shërbejë manuali

Qëllimi themelor i manualit është promovimi i kuptimit, por edhe i dijes mbi qasjen, standardet dhe teknikat e qasjes për PAK në mjedis të ndërtuar dhe shërbime.

Përmes këtij manuali theksohet domosdoshja e përqafimit të parimit të qasjes për PAK në mjedis të ndërtuar (i preferueshëm është koncepti i *Design for all*) nga faza fillestare e projektimit. Manuali do të ketë edhe rekomandime teknike të cilat mund të adaptohen nga rekomandimet tashmë në Udhëzuesin Administrativ 33/2007, rekomandimet teknike nga udhëzues për projektim pa barriera nga vende të ndryshme nga BE. Po ashtu, në manual do të propozohen mënyrat se si të kalkulohet kostoja, dhe si të ndërmerren vendimet gjatë projektimit, aprovimit në dikasterët relevant komunalë. Njëkohësisht, duhet të propozohen mekanizmat për zbatim të legjislacionit në fuqi që ndërlidhet me ndërtimin qasës por edhe për zbatimin e vet manualit.

Manuali duhet të:

- shpjegojë legjislacionin relevant dhe politikat themelore
- të tregojë se si ndërtuesit mund të zbatojnë politikat e caktuara planifikuese
- dhe ofrojë këshilla teknike për realizimin e një mjedisi pa barriera.

Audiencia e gjerë e këtij manuali duhet të jetë nga autoritetet publike, por edhe nga kompanitë private. Në veçanti, kjo audiencë përbëhet nga:

- akterët planifikues në nivel të zhvillimit të politikave,
- ndërtuesit,
- arkitektë dhe projektues,
- akterët logjistikë: OJQ-të,
- shfrytëzuesit, komuniteti PAK dhe organizatat që mbrojnë interesat e tyre,

personat e moshuar, gratë, fëmijët, kuqdestarët, prindërit, dhe secili që është i marginalizuar për shkak të dizajnit jo të mirë të mjedisit.

Strukturimi i manualit

SEKSIONI I. Përkufizimet themelore mbi qasjen

Ky seksion duhet t'i përmbledhë përkufizimet themelore mbi aftësinë e kufizuar, qasjen, barrierat, terminologjinë në fuqi të kësaj fushe, si dhe një përmbledhje të të drejtave që garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe dokumentet ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e këtij komuniteti.

SEKSIONI II: LEGJISLACIONI

- Përmbledhja e legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe e atij të BE-së që ndërlidhet me qasjen e PAK në shoqëri dhe në mjedis të ndërtuar.
- Përmbledhja e legjislacionit të BE-së e cila mund të jetë udhërrëfyese për përvetësimin e politikave dhe standardeve teknike për realizimin e ndërtimit qasës. Me këtë do të mëtohet përafrimi i legjislacionit të vendit me atë të BE-së.

SEKSIONI III: PARIMET ANTROPOMETRIKE

Në këtë seksion është e rëndësishme që të përvijohen nevojat themelore dhe aftësitë e grupeve të ndryshme të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Me përvetësimin e parimeve të Dizajnit për të gjithë, elementi kryesor udhëheqës është masa e trupit të njeriut. Duke qenë se mjedisi i ndërtuar duhet të jetë pa barriera, atëherë, ai duhet t'iu përshtatet të gjithë shfrytëzuesve. Masa njerëzore në këtë kontekst nuk është vetëm një set i madhësive dhe proporcioneve të trupit të njeriut, por është edhe masë e shfrytëzimit si dhe masë e perceptimit. Duhet të kihen parasysh tri kategori themelore të kërkesave bazë: Kërkesat për mobilitet; Kërkesat shqisore dhe kërkesat in-

telektuale/ kognitive. Secila nga këto kërkesa i ka veçoritë e veta, të cilat ndikojnë në përmasat e dhomave, mobiliarit, hapësirës për qarkullim, mënyrës së kapërcimit të disniveleve, marrjes së informatës, komunikimit, etj.

SEKSIONI IV: KËRKESAT THEMELORE PËR QASJE TË PAPENGUAR TË PAK DHE PËR PROJEKTIM DHE NDËRTIM PA BARRIERA

Siç u tha më lart, parimi bazë i cili duhet të udhëheqë hartimin e instruksioneve për projektim pa barriera do të jetë përqafimi i konceptit *Design for all* për të gjitha intervenimet dhe ndërtimet e reja. Vetëm në këtë mënyrë garantohej mjedisi i ndërtuar që nuk përjashton asnjë komunitetet por edhe një shfrytëzueshmëri më e madhe e ndërtesës a hapësirës publike. Paralelisht me këtë proces duhet të hartohen strategji afatshkurtra për përmirësimin e qasjes në të gjitha ndërtesa publike dhe hapësirë publike, si dhe ato afatmesme për largimin e tërësishëm të barrierave ekzistuese në mjedisin e ndërtuar në qytet. Për shfrytëzim më praktik të manualeve por edhe për garantim të përfshirjes së të gjitha aspekteve të mjedisit të ndërtuar në këtë manual, rekomandohet ndarja në pesë kapituj, si vijon:

- Ndërtesat publike
- Ndërtesat e banimit, banimoro-afariste, etj.
- Hapësira publike
- Trashëgimia kulturore
- Hapësira e gjelbër dhe mjediset e mbrojtura natyrore (parqet, pyjet, parqet kombëtare, breglumenjtë, etj.)

Secila nga këto fusha tipologjike të mjedisit të ndërtuar do të kenë dy grupe instruksionesh teknike:

1. Janë parametrat dhe standardet teknike për projektim të ndërtesave të reja duke u bazuar në parimin *Design for all*. Në këtë grup përjashtim bëjnë ndërtesat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore si

dhe mjedisi natyror (përpos parqeve urbane, dhe gjelbërimi urban, etj.)

2. Standardet dhe parametrat teknikë për eliminimin e barrierave ekzistuese të ndërtesat dhe hapësira publike ekzistuese, përmes intervenimeve përmirësuese dhe modernizuese.

Parametrat dhe standardet teknike duhet të jepen me përmasa në cm si dhe ato që janë më komplekset të ilustrohen me vizatime teknike.

Elementet e ndërtesës dhe hapësirës publike për të cilat do të jepen standardet teknike, janë si më poshtë:

- Qasja (shtigjet, transporti publik, transporti individual, infrastruktura rrugore, trotualet, etj.)
- Zonat funksionale (Hyrja, rrugët e evakuimit, korridoret dhe foajetë, hapësirat e mbledhjeve, hapësirat e tregtisë, zyrat, klasat, sanitaret, dhomat terapeutike, lokalet shërbyese)
- Elementet konstruktive dhe funksionale të ndërtesës (rampat, shkallët, liftet, dyer, dritare, dysheme, pajisjet për komunikim, etj.)

3. Organizimi i procesit planifikues

Në këtë manual duhet të jepen edhe instruksione se si të organizohet procesi i hartimit të planeve dhe projekteve për ndërtesa të qasshme.

Nëse përqafohet koncepti i projektimit *Design for all* atëherë, për të arritur një mjedis të ndërtuar të qasshëm kërkohet involvimi i një grupi të ekspertëve të ndryshëm. Instruksionet për planifikim duhet t'i referohen kuadrit ligjor në fuqi, por rekomandohet edhe përdorimi i elementeve të reja, që mund të adaptohen praktika inovative prej udhëzuesve të qyteteve evropiane (p.sh. Berlin – *Design for all*). Instruksionet për procesin e planifikimit dhe projektimit pa barriera duhet të jepen në mënyrë kronologjike, ashtu siç zhvillohet procesi i planifikimit, me faza të cilat ndërtohen mbi njëra-tjetrën.

Fillimisht, programi projektues duhet të përmbajë kërkesat themelore funksionale të ndërtesës që do të ndërtohet, dhe atë e harton kompania apo agjencia ndërtimore në bashkëpunim me shfrytëzuesin. Kërkesat cilësore dhe kuantitative për ndërtim pa barriera duhet të jenë të formuluar në program përmes përmbajtjes hapësinore, funksionale dhe shërbimeve, si dhe konceptin operacional.

Në procesin e planifikimit preliminar, ku duhet të përkufizohet koncepti pa barriera si element i pavarur, i cili do të prezantohet me diagrame dhe prej të cilit pritët të tregohet se si kërkesat për qasje të përkufizuara në programin projektues do të implementohen në fazën planifikuese. Në këtë fazë kërkohet involvimi i një grupi ekspertësh teknikë si dhe i përfaqësuesve të komuniteteve përfshirë edhe komunitetin PAK. Për të siguruar përfshirjen e kërkesave të komunitetit dhe zbatimin e kuadrit ligjor, në kuadër të dikasterit për planifikim dhe urbanizëm në komunë duhet themeluar një bord këshilldhënës apo një zyrë të veçantë e cila merret me këshillim për mjedis të ndërtuar pa barriera. Ky bord duhet të ketë pjesëtarë të komunitetit PAK dhe organizatave që i mbrojnë interesat e tyre, arkitektë e planerë dhe ekspertë të tjerë teknikë, si dhe zyrtarë të planifikimit dhe urbanizmit, dhe shërbimeve publike nga komuna, etj.⁵⁴

4. Hapat e përgjithshëm për të siguruar një qytet pa barriera

1. Evidentimi i gjendjes aktuale në mjedisin e ndërtuar
 - Auditimi i barrierave dhe pengesave në ndërtesa publike dhe hapësirë publike të qytetit për të ditur shkallën e problemit dhe për të planifikuar intervenimet për përmirësim.

- Evidentimi i barrierave arkitektonike në hapësirë publike të vendosen në hartë, për të pasur informata në lidhje me shtrirjen hapësinore të problematikës së qasjes, por edhe për të ofruar komunitetit PAK një informatë shtesë për hapësirat në të cilat aktualisht mund të kenë probleme për qasje.

2. Pjesëmarrja e komunitetit në vendimarrje për mjedisin e ndërtuar është aspekti kryesor për sigurimin e një qyteti pa barriera. Komuniteti, e në veçanti ai i PAK, duhet të jetë pjesë e të gjitha fazave të hartimit të politikave për mjedis pa barriera, por edhe e planifikimit të mjedisit të ndërtuar. Planifikimi me pjesëmarrje siguron që asnjë nga grupet e komuniteteve të mos jenë të përjashtuara nga zhvillimet në shoqëri, meqë hapësira e ndërtuar falë procesit të tillë, promovon lëvizje të lirë, zhvillim, punësim, arsim dhe në përgjithësi barazi sociale.
3. Themelimi i një bordi këshilldhënës për qytet pa barriera në kuadër të departamentit komunal për urbanizëm dhe planifikim. Ky bord i cili do të përbëhet nga përfaqësues të komunitetit (persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, të rinj, gra, komunitetet pakicë, zyrtarë të urbanizmit dhe planifikimit nga komuna, arkitektë, planerë dhe inxhinierë ndërtimi, shoqëri civile, etj.) do të këshillojë rreth zbatimit të kuadrit ligjor dhe politikave për qasje për PAK dhe komunitetet tjera në projektet ndërtimore në qytet; do të involvohet në projektet publike për të bërë auditimin e projekteve në fazën e aplikimit për leje, si dhe do të monitorojë procesin e dhënies së kontratave për punë ndërtimore për ndërtesa dhe hapësira publike, apo cilido intervenim mjedisor që impakt në jetën publike të qytetarëve.
4. Të vendoset një sistem interaktiv dhe i qashtë informativ, përmes aplikacioneve për telefona, kompjuterë, apo sistem sms falas, përmes të cilave qytetarët do të raportojnë problemet e qasjes

⁵⁴ "Barrier-free Concept" Instructions, Accessible Public Buildings, Berlin Design for all, Senate Department for Urban Development and the Environment, maj 2015, http://stadtentwicklung.berlin.de/bauen/barrierefreies_bauen/de/handbuch.shtml

fizike në qytet, shkeljet në ndërtesa dhe hapësirë publike (rampa që ndërtohen jashtë standardeve, bllokim trotuaresh me makina, reklama, sipërfaqe rrugore të dëmtuara, parkingje të PAK të zaptuara nga makina të tjera, etj.)

5. Të bëhet një kampanjë vetëdijesuese për të gjithë qytetarët, në lidhje me rëndësinë e qasjes fizike dhe lëvizjes së lirë për PAK dhe komunitete të tjera në qytet.
6. Të trajnohen zyrtarët e drejtorive relevante në komunë dhe institucione të tjera publike, si dhe arkitektë e planerët aktivë në qytetin e Prizrenit për projektimin pa barriera, zbatimin e rregulloreve dhe kuadrit ligjor për mjedis të ndërtuar të qasshëm.
7. Të futen module të obligueshme për projektim pa barriera në kurset e studimeve të arkitekturës, në Universitetet e vendit.

VI. KONKLUDIM

Ekzistojnë motive të shumta që na bëjnë të ndjekim objektivin e bërjes së qytetit të qasshëm për të gjithë, ndër më të rëndësishmet është fakti se shoqëria duhet të ndërtohet mbi parimet e barazisë dhe dinjitetit si dhe mundësive të barabarta për të gjithë.

Qasja ka të bëjë kryesisht me përditshmërinë, si dhe me të ndërlidhen shumë koncepte të rëndësishme, ndër të cilat janë edhe zhvillimi i kapaciteteve të individëve, dhe të drejtave personale të njerëzve.

Mjedisi i cili është më i qasshëm lejon gjithpërfshirje më të madhe dhe pjesëmarrje të qytetarëve në shoqëri. Mjedisi më i qasshëm mbështetë jetën e pavarur dhe zgjedhjet autonome. Jo vetëm për komunitetin PAK, por për të gjithë.

